



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

RISHIKIMI I STRATEGJISË SHTETËRORE PËR UJËRA 2023-2027

DHE

PLANI I VEPRIMIT 2023-2025

M
M
P
H
I



Albin Kurti

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në një kohë kur ndikimi i ndryshimeve klimatike po rritet gjithnjë e më shumë, Kosova qëndron përkrah vendeve që përballen me mungesë të ujit. Shteti ynë klasifikohet si një vend me stres ujor meqë disponueshmëria e ujit qëndron në vetëm 16% të mesatares rajonale. Kjo statistikë nuk është vetëm një shifër; është thirrje për veprim për të gjithë ne.

Gjetjet e fundit nga Atlasi i Rrezikut të Ujit të Institutit Botëror të Resurseve, paraqesin një pamje globale që rezonon me sfidat tona lokale. Sipas këtij studimi, 25 vende, së bashku me një të katërtën e popullsisë së botës, janë zhytur në thellësi të stresit ujor jashtëzakonisht të lartë. Akoma më alarmante, rreth 4 miliardë njerëz, ose mbi 50% e popullsisë së botës, përballen me kushte të stresit të madh ujor për të paktën një muaj për çdo vit. Këto statistika janë një përkujtues i ashpër se uji është një brengë globale që i tejkalon kufijtë.

Ndryshimi i klimës kërcënon të përkeqësojë situatën e ujit tashmë të brishtë në vendin tonë, duke rrezikuar një ulje të mëtejme të disponueshmërisë së ujit deri në 20% në 20-30 vitet e ardhshme. Kjo krizë e afërt duhet të na nxisë për veprime të menjëhershme dhe vendimtare.

Sektori ynë i agrikulturës është veçanërisht i cenueshëm. Shkrirja e hershme e borës dhe ndryshimi i modeleve të reshjeve prishin ekuilibrin delikat të furnizimit tonë me ujë, duke rrezikuar mundësitë tona për të siguruar ujë të mjaftueshëm për të ujitur në mënyrë efektive të mbjellat. Siguria e ujit është komponent integral i energjisë, turizmit, zhvillimit dhe mirëqenies së përgjithshme të qytetarëve tanë. Këto sfida, nëse nuk trajtohen, mund të kërcënojnë sigurinë ushqimore dhe stabilitetin ekonomik, si dhe mirëqenien shoqërore.

Megjithatë, Strategjia e Ujit për 2023-2027, dhe plani i veprimit shoqëruar, paraqesin pikë kthese për Kosovën. Shpërfaqë vendosmërinë tonë kolektive për të mbrojtur dhe ruajtur resursin tonë më të çmuar.

Komponentët kryesorë të kësaj strategjie përfshijnë zhvillimin e rezervuarëve të rinj për të rritur disponueshmërinë e ujit, trajtimin e avancuar të ujërave të ndotura për të ruajtur cilësinë e ujit, si dhe forcimin e institucioneve të ngarkuara me menaxhimin e resurseve tona ujore.

Në mënyrë thelbësore, ne po hapim dyert për profesionistët e rinj të ujit, duke njohur nevojën për perspektiva të reja dhe zgjidhje inovative. Duke shfrytëzuar energjinë dhe krijimtarinë e rinisë sonë, ne mund t'i përballojmë sfidat e ardhshme me vull të ripërtërirë.

Për më tepër, ne jemi plotësisht të përkushtuar për të nxitur partneritete ndërkombëtare. Uji nuk njihet kufij dhe bashkëpunimi me fqinjët tanë dhe komunitetin global është thelbësor për të zbutur ndikimet e ndryshimeve klimatike në resurset tona ujore. Së bashku, ne mund të ndajmë njohuritë dhe praktikat më të mira, duke siguruar që përpjekjet tona kolektive të japin rezultate pozitive.

Si përfundim, narrativa për ujin e Kosovës, aq sa lokale është edhe globale. Jemi një vend që ka nevojë për veprime të menjëhershme, por jemi gjithashtu pjesë e një komuniteti global që përballlet me sfida të ngjashme. Strategjia e Ujit për 2023-2027 është plani ynë për të zbutur dhe për t'iu përgjigjur sfidave, si dhe për të arritur qëndrueshmëri. Ne jemi zotuar për të mbrojtur resurset tona ujore, për të mbrojtur mjedisin tonë dhe për të siguruar prosperitet për brezat që do të vijnë.

Së bashku, ne mund të lëvizim në rrjedhën e përparimit, duke siguruar që resursi ynë më jetik të rrjedhë lirshëm e të jetë i qëndrueshëm për popullin tonë dhe planetin tonë.

Përzemërsisht,

Albin Kurti

Kryeministër i Republikës së Kosovës



Liburn Aliu

Ministër i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Me të marr përgjegjësinë e Ministrit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, sektori i resurseve ujore dhe ndërlidhja me sektorët brenda Ministrisë siç janë mjedisi, planifikimi hapësinor, banimi, etj. si dhe me sektorët tjerë ekonomik, si p.sh. shërbimet ujore, bujqësia, energjia u vlerësua nga unë dhe kabineti im.

Me vite menaxhimi i duhur i resurseve ujore ndonëse jetik për mjedis, zhvillim ekonomik dhe mirëqenie sociale, ishte lënë anash, deri në degradim të resurseve ujore duke neglizhuar zbatimin e ligjit apo duke e zbatuar atë gabimisht siç ishte rasti i dhënies të së drejtës ujore.

Qysh në fillim u identifikuan lëshime të shumta si me rastin e hidrocentraleve, financimit të projekteve ujore pa kriteret dhe neglizhenca e institucioneve ujore brenda Ministrisë për të marr masa adekuate ndaj keqpërdorimeve, pavarësisht përkeqësimit të gjendjes së resurseve ujore, pavarësisht që Kosova ka mungesë të ujit në dispozicion.

Për të adresuar këto, kemi filluar me reformën e kornizës ligjore dhe institucionale, kemi hapur sektorin ndaj bashkëpunimit ndër-institucional, kemi krijuar hapësirë për profesionistët e rinj dhe krijimin e një programi master në menaxhimin e integruar të resurseve ujore pranë Universitetit të Prishtinës, kemi ngritur kapacitetet financuese në veçanti në zhvillimin e resurseve të reja ujore (akumulimeve), sigurinë e digave ekzistuese, planifikimin e menaxhimit të pellgjeve lumore, hartat e rrezikshmërisë dhe rrezikut nga përmbajtje, zhvillimin e platformës së pagesave ujore, e shumë aktivitete tjera drejt përmirësimit të gjendjes sasiorë dhe cilësore të resurseve ujore në vend.

Me qëllim që qasja jonë të jetë sa ma sistematike, e integruar dhe në bashkërenditje me shfrytëzimin e ujërave nga sektorët tjerë, bëmë rishikimin e strategjisë së ujërave për periudhën pesë (5) vjeçare 2023-2027 dhe hartuam planin e veprimit 2023-2025, dokument ky që buron nga Strategjia Shtetërore e Ujërave 2017-2036.

Zotohem që së bashku me kabinetin tim, stafin e Ministrisë, dhe me Ministrat tjerë përgjegjës për shërbime ujore dhe për bujqësi në veçanti, si dhe në bashkëpunim me Kompanitë Rajonale të Ujit dhe ato të ujitjes, institucionet arsimore, shoqërinë civile dhe mediat të arrijmë synimet e përbashkëta të dakorduara në këtë dokument.

Ju ftojme për përkrahje dhe zë kritik.

Me respekt,

Liburn Aliu

Ministër i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

PËRMBAJTJA

	3	Figurat
	3	Tabelat
	4	Lista e shkurtesave
	5	Përmbledhje ekzekutive
1	6	HYRJE
2	8	METODOLOGJIA
3	10	SFONDI
	10	<i>3.1 Analiza e gjendjes ekzistuese</i>
	16	<i>3.2 Krahasimi me vendet tjera</i>
	21	<i>3.3 Analiza e përparësive, dobësive, rreziqeve dhe mundësive (SWOT Analiza)</i>
	22	<i>3.4 Rolet dhe përgjegjësitë institucionale në sektorin e ujërave</i>
4	23	OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE
	23	<i>4.1 Objektivat strategjike</i>
	24	<i>4.2 Sfidat, orientimet strategjike dhe veprimet e përgjithshme</i>
5	41	MONITORIMI DHE VLERËSIMI
6	42	NDIKIMI BUXHETOR I ZBATIMIT TË STRATEGJISË
	43	<i>Shtojca 1: Ligjet e sektorit dhe aktet nënligjore</i>
	45	<i>Shtojca 2: Institucionet relevante për sektorin e ujërave: rolet dhe përgjegjësitë</i>
7	49	PLANI I VEPRIMIT 2023 - 2025

1

Figurat

- 18 **Figura 1. Nivelet e stresit ujqor të Kosovës në kontekstin rajonal:**
a) burimet e disponueshme ujqore;
b) kapacitetin e depozituar të ujqit për frymë.
- 18 **Figura 2. Disponueshmëria me resurse ujqore në rajon**
- 19 **Figura 3. Krahasimi rajonal i sasisë së ujqit të akumuluar për kokë banori**
- 19 **Figura 4. Burimet e ripërtëritshme ujqore të ndara sipas pellgjeve lumore në Kosovë:**
a) gjendja aktuale,
b) situata e parashikuar (2046-2065)
- 20 **Figura 5. Konsolidimi i Kompanive Rajonale të Ujqit kundrejt kufijve të pellgjeve lumore**
- 22 **Figura 6. Organizimi institucional i sektorit të ujqërave në Kosovë**
- 28 **Figura 7.a Diga e Firajës dhe 7.b Hidrosistemi Ibër-Lepenc, diga e Shtimës**
- 29 **Figura 8. Ujqëmbledhësit e tri digave të mundshme në Kamenicë**
- 31 **Figura 9. Trupat ujqor nëntokësor dhe pikat e monitorimit në pellgun e Drinit të Bardhë**
- 35 **Figura 10. Zonat me rrezik potencial të konsiderueshëm nga përmbytyjet në pellgjet e lumenjve të Kosovës**
- 38 **Figura 11. Menaxhimi i sistemeve rurale të ujqësjes**

2

Tabelat

- 15 **Tabela 1: Zonat e shërbimit të KRU-ve: komunat dhe popullsia**
- 16 **Tabela 2: Performanca e Kompanive Rajonale të Ujqit në vitin 2021**
- 17 **Tabela 3: Sistemet e ujqitjes dhe shkalla e shfrytëzimit të tyre**
- 42 **Tabela 4: Ndikimi buxhetor i zbatimit të Strategjisë për periudhën 2023-2025**

Lista e shkurtesave

AME	Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave	MIRU	Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore
AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës	MIRU-K	Programi "Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore në Kosovë"
ARPL	Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore	MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
ARRU	Autoriteti Rregullator i Shërbimeve të Ujit	MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
BB	Banka Botërore	MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
BE	Bashkimi Evropian	MSH	Ministria e Shëndetësisë
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim	NP	Ndërmarrje Publike
FLAWS	Program i BB: Fostering and Leveraging Opportunities for Water Security	NJPMNP	Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
IFN	Institucionet Financiare Ndërkombëtare	PMPL	Planet për Menaxhimin e Pellgjeve Lumore
IHMK	Instituti Hidrometeorologjik I Kosovës	QeK	Qeveria e Kosovës
IKSHP	Instituti Kombëtar I Shëndetësisë Publike	SCO	Zyra Zvicerane për Bashkëpunim (Swiss Cooperation Office)
ITUN	Impiant për Trajtimin e Ujërave të Ndotura	SHGJK	Shërbimi Gjeologjik i Kosovës
KE	Komisioni Evropian	UA	Udhëzim Administrativ
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim (Kreditanstalt für Wiederaufbau)	VNMS	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social
KNU	Këshilli Ndërmintoror I Ujërave	ZKM	Zyra e Kryeministrit
KRU	Kompanitë Rajonale të Ujit	WBIF	Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor – program I BE
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal		
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë		
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural		
ME	Ministria e Ekonomisë		
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve		

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Uji paraqet një prej elementeve kyçe për realizimin e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit jetësor. Gjendja dhe cilësia e ujërave janë me rëndësi thelbësore për zhvillimin socioekonomik, mbrojtjen e mjedisit jetësor për ekzistencën dhe mirëqenien e njerëzimit.

Si resurs i pazëvendësueshëm i kufizuar, mund të rigjenerohet vetëm nëse i njëjti menaxhohet në mënyrë adekuate. Menaxhimi i qëndrueshëm me resurset ujore paraqet sfidë të madhe dhe çekuilibrimi gjithnjë e më i madh mes ofertës dhe kërkesës për ujë në shumë pjesë të Evropës, si dhe në Kosovë. Dispozicioni i ujit dhe mungesa e ujit gradualisht janë shëndërruar në pikat kryesore gjatë krijimit të politikave për ujë në nivel nacional dhe në nivel të BE-së.

RESURSET UJORE NË KOSOVË PËRDOREN PËR MË SHUMË DEDIKIME, PËRKATËSISHT PËR AKTIVITETE TË CILAT NËNKUPTOJNË SI NË VIJIM :

- ▶ *Furnizimit me ujë të pijshëm,*
- ▶ *Ujë për ujitjen e tokave bujqësore,*
- ▶ *Ujë për industrinë,*
- ▶ *Sport, rekreacion, dhe*
- ▶ *Gjenerimin e energjisë elektrike.*

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË STRATEGJISË SHTETËRORE PËR UJËRA 2023-2027 JANË:

Objekti Strategjik 1

Kompletimi i kuadrit ligjor dhe konsolidimi i kornizës institucionale;

Objekti Strategjik 2

Sigurimi afatgjatë i ujit për shfrytëzuesit dhe siguria e digave ekzistuese;

Objekti Strategjik 3

Mbrojtja e resurseve ujore dhe mbrojtja nga ujërat duke siguruar mbrojtjen e ekosistemit dhe popullatës;

Objekti Strategjik 4

Përmirësimi i besueshmërisë dhe cilësisë së shërbimeve ujore.

Rishikimi i Strategjisë Shtetërore për Ujëra 2023-2027 ka për qëllim menaxhimin më efektiv të resurseve ujore për sigurimin e sasisë së ujit dhe cilësinë e tij të duhur, për nevojat e popullatës dhe të zhvillimit ekonomik.

Me qëllim të arritjes së objektivave themelore sa i përket menaxhimit të resurseve ujore, që janë: mbrojtja e ujërave, mbrojtja nga veprimet e dëmshme të ujërave dhe shfrytëzimi eficient i ujërave, do të përmirësohet me: kornizën ligjore të ujërave, ku hyn rishikimi i ligjit për ujëra apo hartimi i një ligji të ri, kompletimi i akteve nënligjore që kërkojnë për zbatimin e ligjit, si dhe hartimi i ligjit për financimin e menaxhimit të resurseve ujore. Po ashtu, hartimin e planeve për menaxhimin e pellgjeve lumore, studimet e fizibilitetit për lokacionet për akumulimin e ujërave, ndërtimin e digave dhe vlerësimin e sigurisë së digave ekzistuese.

Strategjia Shtetërore për Ujëra 2023-2027 është një dokument i planifikimit afatgjatë i cili përmban metodologjinë, sfondin, SWOT analiza, kuadrin ligjor dhe institucional, vizionin, misionin, objektivat strategjike, veprimet për zhvillimin e politikave ujore në Republikën e Kosovës. Ajo përcakton objektivat specifike, të menaxhimit të resurseve ujore duke filluar nga gjendja ekzistuese e sektorit të ujërave, shtjellimin e kërkesave, strukturat menaxhuese, kërkesat për mbrojtjen dhe përmirësimin e gjendjes së cilësisë së ujërave dhe mbrojtjen nga ujërat.

1. HYRJJE

Strategjia Shtetërore për Ujëra 2023-2027 (tani e tutje: SSHU) është hartuar në përputhje me Nenin 31 të Ligjit për Ujërat e Kosovës. SSHU u miratua në mbledhjen e 20 të qeverisë, vendimi nr. 16/20, datë 20.12.2017 dhe më pas nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në seancën plenare të mbajtur me datë 30.05.2018, vendimi nr. 06-V-137.

Në procesin e hartimit të ligjeve dhe akteve nënligjore, Kosova qartazi synon përafrimin me legjislacionin Evropian duke pasur për qëllim harmonizimin direktivat dhe standartet e Komisionit Evropian. Korniza ligjore për sektorin e ujërave përfshirë dy nën-sektorët kryesor të tij, atë të resurseve ujore dhe të shërbimeve ujore, ligjet janë si në vijim ndërsa aktet nënligjore (shih shtojcën 1):

- ▶ Ligji nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës;
- ▶ Ligji nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike;
- ▶ Ligji nr.05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit;
- ▶ Ligji nr.06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës;
- ▶ Ligji nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit;
- ▶ Ligji (Nr. 03/L-233) për Mbrojtjen e Natyrës;
- ▶ Ligji nr.06/L-035 për Veprimtaritë Hidrometeorologjike;
- ▶ Ligji nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale;
- ▶ Ligji nr. 02/L-078 për Shëndetësi Publike;
- ▶ Ligji nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor;
- ▶ Ligji nr. 02/L-9 për Ujitjen e Tokave Bujqësore.

Përmbajtja e SSHU është në përputhshmëri me UA (QRK) nr. 07/2018 për planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit dhe direktivat relevante të BE-së.

Dokumenti ka shqyrtuar dhe është në linjë me planet dhe strategjitë kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e mjedisit siç janë:

- ▶ Politika e Qeverisë për Ujëra;
- ▶ Strategjia Shtetërore për Ujërat e Kosovës 2017-2036;
- ▶ Strategjia dhe Plani i Veprimit për Ndryshime Klimatike 2019-2028;
- ▶ Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit 2013-2022;
- ▶ Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030;
- ▶ Strategjia e Energjisë 2022-2031;
- ▶ Strategjia për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë dhe Planin e Veprimit 2016-2026;
- ▶ Master Plani i Ujitjes për Kosovë dhe Kornizën Investuese (2020) si dhe
- ▶ Strategjia për Menaxhimin e Sistemeve Rurale të Ujësjellësit dhe Kanalizimit.

Strategjia Shtetërore për Ujëra 2023-2027 po ashtu ndërlidhet edhe me Programin e Qeverisë së Kosovës 2021-2025, pika 2.12.3 Menaxhimi i ujërave dhe ngritja e infrastrukturës, me zbatimin e MSA-së konkretisht me nenin 115 për mjedisin, nenin 116 për ndryshimet klimatike dhe nenin 117 për mbrojtjen civile.

Diskutimet nga strukturat e përbashkëta të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) ndërmjet Kosovës dhe BE-së, rrjedhimisht konkluzionet e dala nga Nën-komiteti për Mjedis, Energji, Transport dhe Zhvillim Rajonal, nxjerrin në pah domosdoshmërinë e rishikimit të një Strategjisë afatgjatë dhe Planit të Veprimit me qëllim të përmirësimit të sektorit në përgjithësi.

Nevoja për të ndërmarr reforma në sektorin e ujërave theksohet gjithashtu edhe në Agjendën e Reformave Evropiane (ERA), në kuadër të prioritetit 2.3. 'Zvogëlimi i ndotjes së ajrit, ujit dhe përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave', dokument ky i cili i përmban prioritetet kryesore në procesin e integritit evropian.

Strategjia Shtetërore për Ujëra 2023-2027 ndërlidhet me zbatimin e Agjendës së Gjelbër, me ç' rast merr parasysh përafrimin dhe zbatimin gradual të legjislacionit të BE-së lidhur me ujërat, përmirësimin e menaxhimit të ujërave të zeza, modernizimin e infrastrukturës së monitorimit të ujërave dhe arritjen e statusit të mirë për të gjithë trupat ujorë.

Strategjia Shtetërore për Ujëra ndërlidhet po ashtu edhe me SDG (Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm), Objektivi 6 – Sigurimi i aksesit në furnizimin me ujë dhe kanalizime për të gjithë, të arrihet qasje universale dhe e barabartë në ujë të pijshëm të sigurt, të përmirësohet cilësia e ujit duke reduktuar ndotjen, eliminuar hedhjen e mbetjeve në mënyrë të pakontrolluar dhe minimizuar derdhjen e kimikateve dhe materialeve të rrezikshme, duke e përgjysmuar përqindjen e ujërave të zeza të patrajtuara dhe duke rritur ndjeshëm riciklimin dhe ripërdorimin e sigurt në nivel, të implementohet menaxhimi i integruar i burimeve ujore në të gjitha nivelet.

2. METODOLOGJIA

Baza ligjore për rishikimin e SSHU është në nenin 31 të ligjit për ujëra, në të cilin theksohet se Ministria¹ harton Strategjinë Shtetërore për Ujëra për një periudhë kohore 20 vjeçare me mundësi rishikimi dhe plotësimi çdo pesë (5) vjet. Ndonëse SSHU ka afat kohor prej 20 vitesh dhe do të vlejë për periudhën kohore të aprovuar, është planifikuar që strategjia të zbatohet në katër periudha kohore,

periudha e parë do të përfshijë vitet 2017 deri më 2021 periudhë për të cilën nuk ka ndonjë vlerësim të zbatimit, periudha e tanishme, e dytë 2022-2026, dhe më pas periudha e tretë 2027-2031 dhe periudha fundit, e katërt 2032-2036.

SSHU kishte paraparë që faza e parë, 2017-2021 të jetë fazë e konsolidimit kurse faza e dytë, 2022-2026 të jetë fazë e zgjerimit, konkretisht në dy drejtime:

1. Investime

- ▶ Program më i gjerë i masave që adresojnë zgjerimin dhe nevojat zhvillimore
- ▶ Shtimi i resurseve ujore (akumulimet)
- ▶ Rritja e fokusit për zgjerimin e mbulueshmërisë me shërbime
- ▶ Rritja e fokusit për uljen e ndotjes (trajtimi i ujërave të ndotura)

2. Kapacitetin Menaxhues

- ▶ Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave (hidrometeorologji, resurset ujore, cilësia e ujit): rritja e gamës së parametrave duke përfshirë ata hidro-ekologjik
- ▶ Përmirësimi i mëtutjeshëm i procesit të planifikimit dhe masave zbatuese – fokus më i madh në vlerësimin ekonomik

Ky rishikim i SSHU përfshin periudhën kohore 2023-2027. Procesi i rishikimit ka qenë gjithëpërfshirës, në konsultim të vazhdueshëm me institucionet shtetërore në nivel qendror dhe lokal, kompanitë rajonale të ujit, shoqërinë civile, profesionistët e rinj, përfaqësuesit e shfrytëzuesve të ujit, akademia dhe partnerët zhvillimorë. Kjo qasje e kishte shoqëruar edhe hartimin e strategjisë bazë, Strategjinë Shtetërore për Ujëra 2017-2036.

Meqenëse nuk ka pasur monitorim të rregullt të zbatimit të SSHU e as vlerësim të zbatimit të saj, ky rishikim është përqëndruar në shqyrtimin e zbatimit të objektivave specifik dhe veprimeve të planifikuara me SSHU dhe përshtatjen e këtyre veprimeve, përshtirë fushëveprimin dhe afatet për zbatimin e tyre brenda objektivave strategjike.

Për Rishikimin e Strategjisë Shtetërore për Ujëra për periudhën 2023 – 2027 është themeluar ekipi i cili ka përgjegjësi për hartimin dhe finalizimin e Rishikimit të SSHU-së.

¹ Sipas ligjit, Ministria përgjegjëse për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor – që aktualisht është Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Ekipi ka mbajtur gjashtë (6) punëtori ku ka shqyrtuar, diskutuar dhe ka marrë vendime strategjike gjatë procesit të përgatitjes së SSHU-së. Për monitorimin dhe zbatimin e SSHU është Ministria përgjegjëse për sektorin e resurseve ujore,

konkretisht Divizioni për Ujëra i Departamentit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave, në bashkëpunim me hisedarët e sektorit të ujërave dhe ministritë e tjera të linjës që kanë përgjegjësi sektorin e ujërave.

ANËTAR TË EKIPIT PËR HARTIMIN E RISHIKIMIN TË SSHU-SË KANË QENË, PËRFAQËSUES NGA:

- ▶ Ministria e Ekonomisë (ME);
- ▶ Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT);
- ▶ Zyra për Planifikim Strategjik/ZKM;
- ▶ Zyra Ligjore / ZKM;
- ▶ Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR);
- ▶ Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL);
- ▶ Zyra e integrimeve Evropiane;
- ▶ Ministria e Shëndetësisë (MSH);
- ▶ Fakulteti i Ndërtimtarisë;
- ▶ SHHIK – Shoqata e Hidroinxhinierve të Kosovës;

Në hartimin e Rishikimit të SSHU-së kanë marrë pjesë dhe kanë kontribuar edhe këshilltarët e Këshillit Ndërmëtor të Ujërave – KNU / ZKM.

3. SFONDI

3.1 Analiza e gjendjes ekzistuese

3.1.1 Menaxhimi i resurseve ujore

a) Kuadri Ligjor - Ligji për Ujërat e Kosovës (Nr. 04/L-147) rregullon të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me resurset ujore si dhe çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e ujërave: shfrytëzimi i ujërave, mbrojtja e ujërave, mbrojtja nga ujërat etj. Gjatë procesit të hartimit të akteve nënligjore që kërkohen sipas këtij ligji, janë identifikuar një numër i konsiderueshëm i mangësive qoftë në aspektin teknik e gjithashtu në atë përmbajtësor që si të tilla shkaktojnë paqartësi dhe rrjedhimisht e bëjnë të vështirë zbatimin e këtij ligji. Konkretisht, në ligj ka kundërthënie dhe paqartësi për konceptet bazë për menaxhimin e ujërave, si: resursi ujqor, pasuria ujore, monitorimi i ujërave, e drejta ujore etj. Për më tepër, në formën si është, ky ligj nuk ka arritur t'i transpozojë shumë prej koncepteve dhe parimeve të Direktivës Kornizë për Ujëra (Direktiva e BE 2000/60/EC) që është legjislacioni bazë i KE-së në fushën e menaxhimit të resurseve ujore.

b) Kuadri Institucional - Struktura institucionale për menaxhimin e resurseve ujore është e pakonsoliduar plotësisht. Kështu, në institucionet kyçe që janë përgjegjëse për planifikimin dhe menaxhimin e resurseve ujore ka mungesë të kapaciteteve. Si rezultat i kapaciteteve të pamjaftueshme, kanë mbetur ende pa u adresuar çështjet bazike të menaxhimit të resurseve si: (i) nuk ka një informacion cilësor dhe të plotë për sa i përket sasisë dhe cilësisë së ujërave, (ii) nuk ka kontroll efektiv mbi shfrytëzimin e ujërave dhe eksploatimin e aluvioneve të lumenjve, (iii) nuk ka mbikëqyrje efektive të cilësisë së shkarkimit të ujërave të ndotura, (iv) shkalla e implementimit të objektivave nga dokumentet e politikave dhe dokumentet strategjike është jashtëzakonisht e ulët, (v) shkalla e zbatimit të legjislacionit në fushën e ujërave ka mbetur shumë e ulët, etj. ARPL sot vepron si një departament në kuadër të MMPHI.

Kategorizimi i ARPL si departament i Ministrisë është problematik sepse nuk është në pajtim me Ligjin 04/L-147 për Ujërat e Kosovës dhe me Ligjin nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës.

Për nevojat e administrimit të ujërave, Kosova trajtohet si një rajon i pellgjeve lumore, dhe për këtë rajon me ligj themelohet Autoriteti (neni 21, para. 1 dhe 2). ARPL e ka e selinë e vet dhe për punën e vet i raporton Ministrit (neni 21, para. 3 dhe 4), si dhe ka kompetenca të veta të ndara nga Ministria (neni 22).

Në anën tjetër, kapacitet e IHMK si një institucion që ka një rol vital për menaxhimin e ujërave duke qenë institucion që prodhon të dhëna dhe informacione të domosdoshme për planifikimin dhe menaxhimin e resurseve ujore, në veçanti ato njerëzore, janë të pamjaftueshme për përmbushjen e përgjegjësive ligjore që ka ky institucion për monitorim efektiv të parametrave kuantitativ dhe kualitativ të ujërave në Kosovë. Sa i përket kapaciteteve në fushën e inspektimit, aktualisht MMPHI i ka vetëm 3 inspektorë të ujërave. Ky numër është i pamjaftueshëm për inspektim efektiv dhe përmbushje të përgjegjësive ligjore që ka inspektori i ujërave. Asnjë komunë nuk ka inspektor të autorizuar për ujëra siç parashihet me ligjin në fuqi.

c) Planifikimi

Planet e menaxhimit të pellgjeve lumore (PMPL) janë dokumentet bazë planifikuese për menaxhimin e pellgjeve lumore të përcaktuara si të tilla me direktivat e BE-së dhe me legjislacionin Kosovar. Përmbajtja e këtyre planeve si dhe çështje tjera për përgatitjen e tyre si, afati kohor, dinamika kohore për përgatitjen e tyre, procesi i konsultimit dhe diskutimit publik janë përcaktuar me Ligjin për Ujërat e Kosovës. Objektivat mjedisore që duhet të arrihen sikurse edhe programi i masave për arritjen e tyre janë pjesë përbërëse të këtyre planeve.

Deri tash, nuk janë kompletuar asnjë prej PMPL, ndonëse plani për Drinin e Bardhë është në proces që pesë vite dhe tani më para përfundimit, me përkrahje të qeverisë Suedeze. Kurse PMPL tjera (Ibër, Lepenc dhe Moravë të Binçës) kanë filluar të përgatiten me përkrahje të një programi të bashkë-financuar nga Qeveria e Zvicrës dhe Qeveria e Kosovës mbi menaxhimin e integruar të resurseve ujore në Kosovë (MIRU-K).

d) Zhvillimi i resurseve ujore

Rezervat e ripërtëritshme të ujit në Kosovë janë relativisht të pakta. Vetëm 10% e ujërave të Kosovës janë ujëra të jashtme (që vijnë nga shtetet fqinje). Ujërat e brendshme gjenerohen nga të reshurat, e që më pas janë një bilans midis reshjeve, avullimit dhe rrjedhjes. Pra shumica e ujërave të Kosovës burojnë brenda shtetit dhe derdhen në shtetet fqinje shpejtë, meqë pozicioni gjeografik dhe territori i vogël i Kosovës pamundëson akumulimin e ujërrjedhave në lumenj dhe liqene natyrore. Rrjedhimisht, siç ishte parashikuar edhe me SSHU 2017-2036, është me prioritet që të shqyrtohet mundësia për zhvillimin e resurseve të reja, që nënkupton ndërtimin e akumulimeve të reja të ujërave, sidomos për pellgjet e Ibër, Moravës së Binçës dhe Lepencit.

Sistemi Ibër-Lepenc u nis në vitet '70ta për të akumuluar ujin nga lumenjtë Ibër dhe Lepenc, me qëllim të furnizimit të qyteteve, bujqësisë, fermave dhe industrive në Kosovën Lindore dhe Jugore. Projekti filloi me ndërtimin e digës së Ujmanit dhe kanaleve që dërgojnë ujë nga lumi Ibër në drejtim të jugut, në drejtim të Prishtinës.

d) Zhvillimi i resurseve ujore

Skema e zhvillimit të lumit Lepenc për furnizimin e jugut të Kosovës u vonua, duke lënë Ferizajn, Shtimen, Gjilanin dhe rrethinat e tyre gjithnjë e më shumë në mungesë të ujit. MMPHI me asistencë nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), porositi një studim në vitin 2017 për të rishikuar dhe përditësuar planet për zhvillimin e lumit Lepenc me një digë devijuese në lumin Lepenc në Firajë dhe një digë akumulimi në një luginë në perëndim të Shtimes.

Në fillim të vitit 2020 studimi raportoi se skema e viteve 1970 mbeti e vlefshme në parim, por kërkonte ndryshime thelbësore për të akomoduar zgjerimin e qyteteve jugore ndër vite. U rekomandua që projekti të zhvillohet në dy faza:

faza 1 ndërtimin e digës së Firajës dhe faza 2 ndërtimin e digës së Shtimes.

Faza 1 përfshin ndërtimin e një dige devijimi në Firajë dhe një sistem tubacioni për të dërguar ujin e shumë të nevojshëm tek tri KRU të cilat ofrojnë ujë të pijshëm për popullatën e 9 komunave në Kosovën Lindore dhe Jugore, respektivisht KRU Hidromorava, KRU Bifurkacioni dhe KRU Prishtina.

Me asistencë të BERZH, përmes programit të BE-së, WBIF (Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor).

Momentalisht është duke u përgatitur Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) dhe Projekti Paraprak për Digën e Firajës dhe gypat e furnizimit me ujë me shumicë në rezervuarët e shërbimit të tre KRU-ve. Me disa fonde shtesë që do të vihen në dispozicion nga BE do të përgatitet dizajni i detajuar dhe dokumentacioni i tenderit.

Pas kësaj, projekti do të jetë i gatshëm të kalojë në procesin e tenderimit ndërkombëtar dhe përzgjedhjen e kontraktorit për zbatimin dhe ndërtimin.

Parashikohet që Projekti i Fazës 1 të jetë gati për ndërtim rreth mesit të vitit 2025 dhe ndërtimi të përfundojë para fundit të vitit 2028.

Njëkohësisht, në kontekst të zhvillimit të resurseve ujore, projekti i financuar nga Banka Botërore (BB) "Nxitja dhe Levimi i Mundësive për Sigurinë e Ujit" (i njohur me akronimin FLOWS, në anglisht – 'Fostering and Leveraging Opportunities for Water Security') i ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me ligjin nr. 08/L-096 është i pari nga dy fazat e programit FLOWS që ka për qëllim përmirësimin e sigurisë afatgjate të ujit të Kosovës dhe aftësisë për t'iu përgjigjur stresit ujqor të shkaktuar nga ndryshimet klimatike.

Me këtë projekt, do të përditësohet pjesa e digave dhe akumulimeve e Masterplanit të vitit 1983, si dhe do të ndihmohet në zhvillimin e PMPL-ve duke siguruar që këto plane do t'i përgjigjen sfidave të gjera të sigurisë së ujit.

e) Monitorimi i ujërave

Parakusht i çdo planifikimi të mirëfilltë është disponueshmëria me të dhëna të përditësuara, të vazhdueshme dhe të besueshme. Pra është e domosdoshme që të ketë informacione të duhura për gjendjen ekzistuese të ujërave (sasinë dhe cilësinë) të cilat do të duhej të siguroheshin me procesin e monitorimit të ujërave. Mungesa e këtij informacioni e vështirëson shumë hartimin e planeve të menaxhimit të pellgjeve lumore. Monitorimi i cilësisë dhe sasisë së ujërave, përkundër një progresi të vogël sa i përket krijimit të rrjetit të monitorimit të ujërave nëntokësore, mbetet sfidë, në veçanti monitorimi biologjik i cilësisë së ujërave dhe monitorimi i substancave prioritare ndotëse.

f) Mbrojtja e lumenjve nga degradimi

Problemi i degradimit të lumenjve si pasojë e shfrytëzimit të aluvioneve (inerteve) është konstatuar në raportet e shumta. Duke pasur parasysh efektet jashtëzakonisht negative afatshkurta dhe afatgjata nga kjo dukuri dhe faktin që masat e deritashme nuk kanë dhënë efekt, kjo problematikë duhet të rishikohet në tërësi si në aspektin rregullativ / ligjor dhe në veçanti në planin zbatues në mënyrë që të vendoset një sistem efikas që parandalon degradimin e mëtutjeshëm të ujërave.

Në anën tjetër, një ndër problemet më të mëdha, më të pakuptueshme dhe më të dukshme është ndotja e lumenjve me mbeturina. Sado që Ministria ka tentuar të parandalojë hedhjen e mbeturinave dhe të caktojë gjoba, mungesa e veprimit konkret, mungesa e inspektorëve qendror dhe komunal, si dhe mungesa e dënimeve nga gjykatat e ka lënë këtë problem në dorë të organizatave joqeveritare.

g) Erozioni

Një ndër sfidat më së paku të trajtuara është kontrolli i erozionit. Të dhënat rreth gjendjes me erozion janë kryesisht nga vitet e '80-ta. ARPL është drejtpërdrejtë kompetent për mbrojtjen nga erozioni dhe për përcaktimin e zonave erozive brenda pellgut lumor dhe caktimin e masave mbrojtëse, ndërsa komuna është përgjegjëse për mbrojtjen nga erozioni në zonën urbane. Por fatkeqësisht në mungesë të ekspertizës së tillë në Kosovë, mungon edhe staf kompetent për ta trajtuar këtë çështje, qoftë në nivel qendror e aq ma pak në nivel lokal.

h) Mbrojtja nga përmytjet

Kosova ka plotësuar kërkesën e parë të Direktivës për Përmytje të BE-së duke zhvilluar Vlerësimin Preliminar të Rrezikut nga Përmytjet për çdo pellg lumor. Vlerësimi paraprak i rrezikut nga përmytjet, i përfunduar me mbështetjen e WBIF (për pellgjet e lumenjve të lbrit, Lepencit dhe Moravës së Binçës) dhe GIZ (për pellgun e lumit Drini i Bardhë), ka analizuar 834 zona kadastrale me një sipërfaqe totale prej 7,056 km². Në rrezik përmytjeje janë 123 km², 341,244 banorë dhe 57,784 familje, 32 vende kulturore dhe historike, 57 zona të mbrojtura dhe pika të nxehta dhe 538 zona me rëndësi ekonomike. Studimet kanë identifikuar 398 Zona me Rrezik Potencial të Konsiderueshëm nga Përmytjet, nga të cilat 108 janë në rrezik ekstrem, 95 janë në rrezik shumë të lartë dhe 195 janë në rrezik të lartë.

Zhvillimi i Vlerësimit Preliminar të Rrezikut nga Përmbytjet ishte fillimi i një programi më të gjerë për rehabilitimin dhe ndërtimin e infrastrukturës për mbrojtjen nga përmbytjet në Kosovë, duke u fokusuar në nevojat për investime dhe duke synuar menaxhimin e qëndrueshëm të përmbytjeve, me mbështetjen e mundshme të Bankës Evropiane të Investimeve (EIB). Programi pritet të kontribuojë në një zhvendosje nga qasja aktuale kryesisht reaguese ndaj menaxhimit të përmbytjeve drejt një qasjeje të bazuar në ujëmbledhës që merr parasysh faktorët socialë dhe ekonomikë afatgjatë, duke maksimizuar përdorimin e proceseve dhe sistemeve natyrore, të mbështetur nga ndërhyrjet strukturore dhe jo-strukturore që duhen identifikuar.

3.1.2 Shërbimet e ujit

a) Struktura organizative

Sektori i shërbimeve të ujit, në anën tjetër, ka një strukturë organizative dhe institucionale të konsoliduar dhe shumë mirë e rregulluar – madje e njëjta vlerësohet si model edhe për vendet e rajonit. Organizimi i shërbimeve përmes Kompanive Rajonale të Ujit (KRU-ve) dhe ekzistenca e rregullatorit të pavarur vlerësohen si avantazhe të mëdha strukturore të të cilat kanë ndikuar në ngritjen e efikasitetit dhe qëndrueshmërisë financiare të KRU-ve.

Në përgjithësi, sistemet ekzistuese të shpërndarjes së ujit për përdorim shtëpiak dhe ujitje janë kryesisht efikase por që me rast të ndryshimeve klimatike situata ka tendencë të përkeqësohet me shpejtësi. Ekziston nevoja për legjislacion dhe politika për të inkurajuar kontraktimin e jashtëm të disa shërbimeve të kompanive të ujit dhe të ujitjes.

b) Mbulimi i popullsisë me shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit

Shkalla e mbulimit të popullsisë me shërbimet publike të furnizimit me ujë dhe kanalizim në vitet e fundit është rritur dukshëm. Kështu, sipas të dhënave në dispozicion, aktualisht rreth 79% e popullsisë së Kosovës ka qasje në sisteme publike të ujësjellësit dhe rreth 65% në sistemet publike të kanalizimit.

c) Cilësia e ujit

Cilësia e ujit e cila furnizohet përmes sistemeve publike të ujit që menaxhohen nga KRU-të është, në përgjithësi, në pajtim me standardet në fuqi². Cilësia e ujit mbikëqyret nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i cili sipas legjislacionit në fuqi e ka këtë përgjegjësi dhe raporton për cilësinë e ujit të furnizuar përmes sistemeve publike të ujësjellësit.

d) Tarifat e shërbimeve

Çmimi që paguajnë qytetarët dhe bizneset e Kosovës për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit është dukshëm nën pragun e përbalueshmërisë (3% të hyrave mesatare mujore për një familje) sipas të gjitha standardeve ndërkombëtare dhe më i ulët se në vendet e rajonit³.

e) Trajtimi i ujërave të ndotura të kanalizimit

Një ndër nënsektorët më dinamik viteve të fundit është ndërtimi i impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura (ITUN-ve) urbane. Sot impiante funksionale për trajtimin e ujërave të ndotura ka në Skenderaj, Prizren, Junik, Pejë dhe Gjakovë. Po ashtu janë siguruar fondet, përmes kredive, dhe kanë nisur punimet për impiantin rajonal të Prishtinës së bashku me komunat e Fushë Kosovës, Obiliqit dhe Graçanicës, si dhe për impiantet në Mitrovicë dhe Gjilan. Kurse për Ferizaj diskutimet mes KRU Bifurkacioni dhe kompanisë hungareze dështuan dhe rrjedhimisht skadoi afati i efektshmërisë së kredisë hungareze. Pra gjithsej janë 27 zona urbane që nuk kanë ndonjë zotim konkret. Përveç ITUN-ve urbane ka edhe 13 impiante të vogla në disa zona rurale: Harilaç (në Fushë Kosovë), Mramor (Prishtinë),

² Sipas raportit vjetor të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike për vitin 2021, 98.1% prej 20336 mostrave të analizuar në tërë Kosovën janë në pajtim me standardet e përcaktuara të cilësisë.

³ Raporti Vjetor i Punës 2021 të Autoritetit Rregullator për Shërbime të Ujit - http://www.arru-ks.org/assets/cms/uploads/files/Publikimet/raportetvjetore/2022-03-30_RAPORTIPUNES-2021ALB.pdf

Skivjan (Gjakovë), impianti për Kuk dhe Kosavë (Dragash), Kukjan (Dragash), impianti për Vrellë dhe Medvec (Lipjan), Hallaq i Madh (Lipjan), Kramovik (Rahovec), Volljak (Klinë), Marmull (Gjakovë), Tërnac (Skenderaj), Banjë të Pejës (Istog), dhe Orllan (Podujevë). Duhet theksuar që trajtimi i ujërave të ndotura është pjesë e shërbimeve të ujit dhe rrjedhimisht bie nën përgjegjësi të ME si bartëse, por që edhe MMPHI ka përgjegjësi në kuptim të përcaktimit të standardeve mjedisore. Impiantet për trajtimin e ujërave të ndotura për qytetet kryesore janë veçse operationale (Prizren – 50.000 b.e, Gjakovë – 30.000 b.e, Pejë – 60.000 b.e).

f) Zonat e shërbimit të Kompanive Rajonale të Ujit (KRU-ve)

Në tabelën më poshtë janë paraqitur të dhënat për zonat e shërbimit të KRU-ve - komunit që mbulojnë secila prej KRU -ve dhe popullsia që shërbehet.

Tabela 1 : Zonat e shërbimit të KRU-ve: komunit dhe popullsia

Nr.	KRU	Komunit e shërbyera	Popullsia e shërbyer
1	Prishtina	□ Prishtina	220,323
		□ Podujeva	88,018
		□ Fushë Kosova	40,432
		□ Obiliqi	18,419
		□ Lipjani	58,601
		□ Shtimja	27,779
		□ Gllgovci	61,939
		□ Graçanica	12,149
		Σ[527,660]	
2	Hidroregjioni Jugor	□ Prizreni	195,881
		□ Suhareka	58,878
		□ Malisheva	58,154
		□ Dragashi	34,034
		□ Mamusha*	5,949
		Σ[352,896]	
3	Hidrodrini	□ Peja	99,073
		□ Istogu	41,397
		□ Klina	40,913
		□ Deçani	42,755
		□ Juniku	6,404
		Σ[230,542]	
4	Mitrovica	□ Mitrovica	69,866
		□ Vushtrri	63,473
		□ Skenderaj	53,277
		Σ[186,616]	
5	Gjakova**	□ Gjakova	94,924
		□ Rahoveci	57,575
		Σ[152,499]	
6	Hidromorava	□ Gjilani	77,630
		□ Vitia	48,290
		□ Kamenica	28,017
		□ Novobërda*	7,157
		□ Ranillugu*	3,706
		□ Klllokoti*	2,718
		□ Parteshi*	1,683
		Σ[169,201]	
7	Bifurkacioni	□ Ferizaj	107,378
		□ Kaçaniku	34,988
		□ Hani i Elezit	10,171
		□ Shtërpca*	6,580
		Σ[159,117]	

Shënim:

(*) - nuk janë marrë ende në menaxhim nga KRU

(**) - i ka nën menaxhim edhe disa fshatra të komunës së Prizrenit

g) Performanca e KRU -ve

Sipas ARRU, performanca e shërbimeve të ujit për vitin 2021 (pa përfshirë veriun e Kosovës dhe vendbanimet me sisteme vetanake) është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela2: Performanca e Kompanive Rajonale të Ujit në vitin 2021

KRU	Nr. Kons.	Popullsia me shërbime të ujësjellësit	Popullsia me shërbime të kanalizimit	Qasja në ujësjellës publik	Qasja në kanalizim	Uji i pafaturuar (%)	Uji i pafaturuar (m ³)	Arkëtimi (%)
Prishtina	153,509	434,270	408,621	83%	78%	58%	32,013,675	91%
Hidrorejioni Jugor	54,104	218,371	216,280	66%	65%	54%	9,209,719	100%
Hidrodrini	53,205	196,654	104,871	85%	45%	58%	14,509,230	129%
Mitrovica	43,897	161,161	121,341	80%	60%	55%	15,156,096 ⁴	74%
Gjakova	43,737	172,632	117,428	99%	67%	42%	6,742,405	103%
Bifurkacioni	33,551	124,531	113,818	81%	74%	57%	4,695,808	80%
Hidromorava	34,703	115,613	94,386	61%	50%	48%	3,762,981	92%
SEKTORI	416,706	1,423,232	1,176,746	79%	65%	55%	86,089,914	96%

h) Humbjet e ujit

Humbjet e larta të ujit vazhdojnë të jenë një problem serioz dhe rrjedhimisht ndër sfidat kryesore për qëndrueshmërinë financiare të KRU-ve. Kjo për faktin se aktualisht më tepër se gjysma e ujit të trajtuar të cilin KRU-të e distribuojnë në sistem (86 milion m³ nga 156 milion m³) nuk faturohet si pasojë qoftë e humbjeve fizike (rrjedhjet nga gypat) apo humbjeve komerciale (gabimet në matje dhe lexim, vjedhjet etj.). Shkalla kaq e lartë e humbjeve të ujit jo vetëm që shkakton humbje substanciale financiare për KRU-të por ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e furnizimit të konsumatorëve (ndërprerjet e shpeshta në furnizim) që ka për pasojë rrezikimin e cilësisë së ujit dhe rrjedhimisht paraqet kërcënim për shëndetin e popullatës.

Në periudhën 2018-2021 ka pasur një progres modest sa i përket zvogëlimit të humbjeve të ujit (nga 58% janë zvogëluar në 55%) si rezultat i zbatimit të Strategjive të hartuara nga KRU-të për periudhën 2018-2022. Progresi i arritur, megjithatë, është i pamjaftueshëm për arritjen e synimit për zvogëlimin e humbjeve të ujit në nivel të sektorit që ishte përcaktuar të jetë në shkallën nën 50%.

Humbjet mbeten ndër sfidat kryesore të shërbimeve ujore - janë të mëdha, më të ulëta se rajoni megjithatë, dhe nga to shumica janë humbje komerciale (kyçje ilegale, mos-regjistrimi i konsumatorëve, etj.).

i) Investimet

Sot kemi projekte përmes granteve, në realizim ose në përgatitje, në vlerë prej 163.3 mil. € me 32.3 mil. € bashkëfinancim nga Qeveria dhe/ose komunat, ose zotim të porealizuar akoma. Në anën tjetër, Kosova ka hyrë në marrëveshje për kredi në vlerë prej 200 mil. €, që përfshinë rreth 5 mil. € grant dhe 20 mil. € bashkëfinancim nga Qeveria (kjo vetëm për projektin e trajtimit të ujërave të zeza në Prishtinë). Kurse projektet e planifikuara janë kryesisht studime përmes granteve por që shpijnë në huamarrje, dhe nëse realizohen do të kapin vlerën mbi 370 mil. €.

⁴ Uji i pafaturuar te KRU Mitrovica është llogaritur duke përfshirë edhe ujin e shitur për pjesën veriore të Mitrovicës

3.1.3 Ujitja

Sa i përket ujitjes, në vitet e `50 u ndërtuan 14 sisteme të vogla të ujitjes në rrafshin e Dukagjinit që mbulonin një sipërfaqe prej 19,000 ha. Në vitet e `80 Banka Botërore kishte financuar dy projekte hidroteknike shumëfunktionale duke përfshirë edhe komponentin e ujitjes: a) Sistemi i ujitjes Radoniqi (1977-1984), për 10,250 hektarë, b) Sistemi i ujitjes Ibër-Lepenc (1978-1984), për 19,000 hektarë. Sipërfaqja totale nën ujitje të organizuar në gjashtë kompani të ujitjes ishte 70,226 hektar. Në vitin 1989 kanë qenë funksionale dhe ujiteshin rreth 52,354 ha, ose 75% të tokave nën sisteme.

Sot, sektori i ujitjes ka një regres të jashtëzakonshëm, dhe përkundër investimeve nga projekte të donatorëve nuk arriti që të rehabilitohet në tërësi. Ndonëse, sipërfaqet nën sistemet e ujitjes mbulojnë rreth 57,000 ha, sipërfaqet e ujitura në vitin 2018 ishin vetëm 8,500 ha (vetëm 15%!). Sipas të dhënave statistikore në vitin 2014 në Kosovë ujitën rreth 22,800 ha, përfshi ujitjet jashtë sistemeve të ujitjes nga fermerët direkt nga lumenjtë apo ujëra nëntokësorë.

Tabela 3: Sistemet e ujitjes dhe shkalla e shfrytëzimit të tyre

Sistemi i ujitjes	Tëknikat e ujitjes		Sipërfaqet në sistem (ha)	Sipërfaqet e ujitura 2004 (ha)	Sipërfaqet e ujitura 2018 (ha)
Ibër-Lepenc	Ujitje spërkatës	me	20,000	515	2,000
Radoniqi	Ujitje spërkatës	me	8,600	4,700	4,800
Dukagjini	Ujitje spërkatës	me	5,000	800	600
Drini Bardhë Pejë	- Ujitje sipërfaqësore		6,500	1,300	700
Drini i Bardhë Burim	- Ujitje sipërfaqësore		8,500	1,350	200
Lum bardhi Deçan	- Ujitje sipërfaqësore		8,500	1,650	200
Total	-		57,100	10,315	8,500

Kjo shkallë e ulët e shfrytëzimit të sistemeve të ujitjes është kryesisht pasojë e sistemeve të vjetruara si Drini i Bardhë në Pejë, Burim dhe Deçan, urbanizimit të hovshëm në sistemin e Dukagjinit në Prizren si keqmenaxhimit në Ibër-Lepenc, si dhe mungesës së perspektivës në sektorin e bujqësisë sidomos për gjeneratat e reja, politikës jo të favorshme fiskale dhe kredituese për sektorin e bujqësisë si dhe konkurrencës së fuqishme nga importi i produkteve ushqimore/bujqësore.

3.2 Krahasimi me vendet tjera

Krahasuar me vendet në rajon si Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Bosnja Hercegovina, Kosova ka më së paku resurse ujore për kokë banori.

Vetëm 10% e ujërave të Kosovë vijnë nga jashtë, Mal i Zi, kurse të tjerat burojnë në Kosovë dhe derdhen jashtë Kosovës në Detin Adriatik (pellgu i Drinit të Bardhë), Detin e Zi (pellgjet e Ibrit dhe Moravës së Binçës), dhe Detin Egje (pellgu i Lepencit).

Një shtet konsiderohet të ketë ujë të mjaftueshëm nëse ka mbi 1700 m³/banor/vit. Kosova sipas SSHUK konsiderohet të ketë 1600 m³/banor/vit⁵, që e bë Kosovën shtet me stres ujor. Bilanci i ujërave i bërë nga programi MIRU-K e cakton këtë figurë në 1578 m³/banor/vit që është shumë e përafërt me figurën në SSHUK. Analiza e bilancit të ujit u krye nëpërmjet aplikimit të një morie platformash të avancuara të modelimit hidrologjik.

Një nga 'risitë' e studimit ishte mënyra se si trajtohen boshllëqet e të dhënave. Studimi arriti të plotësonte boshllëqet e rëndësishme në të dhënat e klimës dhe shkarkimit të lumenjve duke marrë seri të gjata të dhënash klimatike të bazuara në satelit dhe duke aksesuar të dhënat e matura nga të gjitha vendet fqinje (p.sh., për shkarkimet e lumenjve ndërkufitarë). Kjo ka përmirësuar saktësinë e modeleve dhe vlefshmërinë e rezultateve të gjeneruara.

Në kontekst të krahasimit rajonal, Kosova ka ma së paku ujë në dispozicion për kokë banori në vit sipas Indeksit të Falkemark (fig. 1).




Figura 1:

Nivelet e stresit ujor të Kosovës në kontekstin rajonal: a) burimet e ripërtëritshme të disponueshme ujore m³/banorë/vit; b) resurset ujore të akumuluar për kokë banori, nga Vlerësimi i Bilancit Ujor Programi MIRU-K.

Ose thënë ndryshe Kosova ka sa 16% e mesatares së rajonit (fig. 2).




Figura 2. Disponueshmëria me resurse ujore në rajon

Uji i akumuluar për kokë banori është rreth 300 m³ në krahasim me 696 m³ sa është mesatarja në rajon, pra vetëm 42% të rajonit (fig. 3).

⁵Kjo figurë kontestohet, dhe varion, p.sh. sipas master planit të ujitjes (i financuar me kredi nga Banka Botërore) thuhet se ka 1890 m³/banor/vit. Sidoqoftë, mbetet fakt se Kosova ka më së paku disponueshmëri të ujërave në rajon. Bilanci i ujërave i bërë nga programi MIRU-K e cakton këtë figurë në 1578 m³/banor/vit që është shumë e përafërt me figurën në SSHUK.




Figura 3. Krahasimi rajonal i sasisë së ujit të akumuluar për kokë banori

Disponueshmëria me ujëra varion sipas pellgjeve, ku pellgu i Drinit të Bardhë me 2211 m³/b/v ka ujë të mjaftueshëm, kurse pellgjet tjera kanë stres ujor: Morava e Binçës = 1380 m³/b/v, Ibrë = 1092 m³/b/v dhe Lepenci = 1320 m³/b/v. Situata bëhet më e ndërlikuar duke marrë parasysh pabarazinë brenda vendit të disponueshmërisë së burimeve ujore sipas pellgjeve dhe tendencave negative të parashikuara të përcaktuara nga skenarët klimatikë mbizotërues.

Me ndryshimet klimatike, pritet që deri më 2050, disponueshmëria me ujë të bie për 20%. Figura 4 paraqet një modelim tjetër klimatik dhe mungesën e ujërave sidomos në pellgun e Ibrës, dhe mungesën e shtuar në gjitha pellgjet tjera.




Figura 4: Burimet e ripërtëritshme ujore të ndara sipas pellgjeve lumore në Kosovë: a) gjendja aktuale, b) situata e parashikuar për vitet 2046-2065 sipas skenarit të moderuar të ndryshimeve klimatike RCP 4.5 (që stabilizon forcën rrezatuese në 4.5 Wat për metër katror), nga Vlerësimi i Bilancit Ujor, Programi MIRU-K 2021.

Duke u nisur nga të dhënat e paraqitura në SSHUK 2022-2026 se të reshurat vjetore për kokë banori janë 4,107 m³ në krahasim me 10,705 m³ në rajon, që i bie 42% më pak se në rajon dhe paralajmërimi se situata

pritet të përkeqësohet me ndryshime klimatike, si dhe duke u nisur nga fakti që Kosova sot ka deficit të ujërave të akumuluar për kokë banori, imponohet nevoja për mbrojtjen e resurseve aktuale dhe zhvillimin e akumulimeve të reja.

Sa i përket kapaciteteve njerëzore të punësuar në institucionet relevante të menaxhimit të resurseve ujore, raporti i Kosovës krahasuar me Slloveninë është 1:4.5 (127 : 567), ndërsa, sa i përket buxhetit vjetor të institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e resurseve ujore raporti është 1:6 (11.3 : 67). Ky është një ilustrim i nevojës për shtimin e kapaciteteve njerëzore në menaxhimin e resurseve ujore dhe po ashtu i nevojës për rritjen e investimeve në menaxhimin e ujërave.

Në anën tjetër, nënsektori i shërbimeve ujore (shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimit) ka një performancë më të mirë se sa e vendeve të rajonit. Kjo është konfirmuar dhe vlerësuar edhe në raportet e organizatave ndërkombëtare ku qëndrueshmëria e sektorit të shërbimeve të ujit të Kosovës vlerësohet dukshëm më e avancuar se sa e të gjitha vendeve të rajonit (Serbisë, Shqipërisë, Malit të Zi, Maqedonisë, Bosnjës), madje më e mirë ose e barabartë me disa prej vendeve të BE-së (Rumania, Bullgaria)⁶.

Zvogëlimi i humbjeve të ujit (uji i pafaturuar) është sfida më e madhe e këtij sektori. Bazuar në raportet e Autoritetit Rregullator për Shërbime të Ujit (ARRU), ky tregues ka shënuar një progres të vogël në periudhën e kaluar 5-vjeçare – në vitin 2021 humbjet e ujit janë zvogëluar në 55% nga 58% sa kanë qenë në vitin 2017. Përkundër këtij progresi, kjo mbetet sfida më e madhe e KRU-ve. Duhet theksuar, megjithatë, se humbjet e ujit në vendet e rajonit janë kryesisht të larta, madje në shumicën e vendeve të rajonit ato janë më të larta se në Kosovë⁷ (Shqipëria 65%, Maqedonia e Veriut 62%, Mali i Zi 68%) gjë që tregon se zvogëlimi i humbjeve të ujit është një sfidë e cila kërkon përkushtim maksimal të kompanive të ujësjellësit dhe mbështetje nga institucionet relevante. Struktura rajonale e organizimit të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit në Kosovë ka ndikuar që efikasiteti i stafit të jetë relativisht i mirë krahasuar me disa vende të rajonit: me 4.8 të punësuar për 1000 konsumatorë, Kosova qëndron më mirë se sa Shqipëria (5), Bosnja e Hercegovina (7) dhe Mali i Zi (5). Është me rëndësi të theksohet se tarifat për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit në Kosovë janë më të ulëta krahasuar me të gjitha vendet e rajonit: Shqipërinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbinë, Kroacinë, Bosnje Hercegovinën.

Në figurën 5 më poshtë është paraqitur harta me zonat e shërbimit të shtatë KRU-ve kundrejt kufijve të pellgjeve lumore.




Figura 5. Konsolidimi i Kompanive Rajonale të Ujit kundrejt kufijve të pellgjeve lumore, Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit 2007.

⁶ Shih Raportin e Bankës Botërore: “State of Sector, 2018 update”, qershor 2019 - https://sos2018.danubis.org/files/File/SoS_Report-2018.pdf

⁷ Shih Raportin e Punës për Vitin 2021 të Autoritetit Rregullator për Shërbime të Ujit, publikuar në mars 2022 - http://www.arru-rks.org/assets/cms/uploads/files/Publikimet/raportetvjetore/2022-03-30_RAPORTIPUNES-2021ALB.pdf.

3.3 ANALIZA E PËRPARËSIVE, DOBËSIVE, RREZIQEVE DHE MUNDËSIVE (SWOT ANALIZA)

PËRPARËSITË:	DOBËSITË:
<ol style="list-style-type: none"> 1. Ndarja e përgjegjësive mes resurseve ujore dhe shërbimeve ujore 2. Konsolidimi i shërbimeve ujore 3. Korniza ligjore e plotësuar dhe bazuar në legjislacionin Evropian 4. Qeverisja korporative e KRU -ve 5. Rregullatori ekonomik për shërbime të ujit i pavarur 6. Qasja e lartë në ujësjellës 7. Tarifat uniforme për shërbime të ujit 8. Mundësitë për ndërtimin e akumulimeve të reja ujore 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mungesa e kapaciteteve që merren me resurse ujore (diga, menaxhim i erozionit, trajtimi i ujërave të ndotura) 2. Mungesa e zbatimit dhe fuqizimit të ligjeve sidomos në nivel lokal 3. Vonesa e hartimit të PMPL 4. Mungesa e resurseve ujore të disponueshme për kokë banori në vit 5. Përzierja e përgjegjësive institucionale për resurse dhe shërbime ujore 6. Mosveprimi i komunave në trajtimin e problemit të ujërave atmosferike 7. Mungesa e veprimit për trajtimin e ndotësve industrial 8. Mungesa e kompletimit të rrjetit të monitorimit të ujërave. 9. Humbjet e ujit në sistemet publike
MUNDËSITË:	RREZIQET :
<ol style="list-style-type: none"> 1. Ngritja e kapaciteteve 2. Zhvillimi i trajtimit të ujërave të ndotura nga pika zero 3. Gatishmëria e agjencive zhvillimore ndërkombëtare për të përkrah sektorin e ujërave 4. Fokusi në projekte për zhvillimin e resurseve të reja ujore 5. Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vonesat me ndërtimin e akumulimeve të reja 2. Rritja e shpeshtësisë dhe gjatësisë së thatësirave si pasojë e ndryshimeve klimatike 3. Humbja e cilësisë së resurseve ujore për shkak të ndotjes (Ndotësit industrial) 4. Shfrytëzimi i ashpër i resurseve: uji, zhavorri, biodiversiteti, mineralet

3.4 ROLET DHE PËRGJEGJËSITË INSTITUCIONALE NË SEKTORIN E UJËRAVE

Detyrat e menaxhimit të ujit përfshijnë një sërë aktivitete, nga miratimi i ligjeve deri të organizimi i mirëmbajtjes dhe monitorimit të drejtpërdrejtë të gjendjes së sistemit ujor. Bartës të autorizuar dhe përgjegjës të këtyre aktiviteteve janë: Kuvendi i Kosovës, Autoriteti Rregullator i Ujërave, Qeveria e Republikës së Kosovës me Këshillin Ndërmintor për Ujëra, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me Autoritetin Rajonal të Pellgjeve Lumore, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe organe të tjera të administratës shtetërore e të pushtetit lokal.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në bazë të *Rregullores (QRK)-Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive*, është kompetente për përgatitjen e politikave publike, hartimin e akteve ligjore, hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore, zbatimin e tyre, si dhe përcaktimin e standardeve të detyrueshme në fushën e ujërave.




Figura 6. Organizimi institucional i sektorit të ujërave në Kosovë

4. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE

VIZIONI

Menaxhimi i integruar dhe i qëndrueshëm i resurseve ujore në aspektin e sasisë së mjaftueshme dhe cilësisë së mirë për të gjithë përdoruesit në përputhje me legjislacionin e KE për ujin.

MISIONI

Të garantohet siguria ujore në vend, ku të gjithë përdoruesit të kenë sasi të mjaftueshme dhe cilësi të mirë të ujit.

4.1 Objektivat strategjike

SSHUK 2022-2026 përcakton objektivat strategjike në kontekst shumë të gjerë, si në vijim:

- o Alokimi dhe mbikëqyrja e qëndrueshme e të drejtës për eksploatimin e burimeve ujore të Kosovës ndërmjet shfrytëzuesve të ujit ashtu që të garantohet qasja në ujë të sigurt për pije për të gjithë dhe të maksimizohen përfitimet ekonomike nga shfrytëzimet tjera të ujit, duke marrë parasysh ndryshimet e regjimeve hidrologjike, eliminimin e mungesës së ujit dhe respektimin e parimeve për menaxhim të qëndrueshëm.
- o Rregullimi dhe mbikëqyrja e aktiviteteve që shtojnë presionin në mjedisin ujor në një mënyrë proporcionale, eficiente dhe efektive ashtu që të arrihen objektiva mjedisore ekonomikisht të justifikueshme për ujërat sipërfaqësore dhe ato nëntokësore duke respektuar parimet e menaxhimit të qëndrueshëm.
- o Arritja e niveleve të pranueshme të mbrojtjes së popullsisë dhe pronës nga efektet e dëmshme të ujit duke përfshirë vërshimet dhe erozionin në mënyrë të balancuar dhe me kosto efektive.
- o Vendosja dhe mirëmbajtja e një sistemi të menaxhimit të ujërave që është i drejtë, transparent, eficient, i koordinuar me kapacitete të atilla teknike dhe profesionale që të jetë në gjendje të mbështesë arritjen e objektivave strategjike për shfrytëzimin e ujit, mbrojtjen e ujit dhe mbrojtjen nga uji duke përfshirë implementimin e një sistemi informativ ujor për monitorimin, vlerësimin, interpretimin dhe informimin e palëve të interesit për të gjitha aspektet e kësaj Strategjie.
- o Arritja e pajtueshmërisë afatgjatë me kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian në sektorin e ujërave fillimisht përmes adoptimit të sistemeve kompatible të legjislacionit dhe planifikimit dhe më pastaj përmes aplikimit hap pas hapi të masave praktike implementuese.

Objektivat strategjike janë riformuluar në kontekst të periudhës 5 vjeçare dhe për secilin objektivat strategjik janë paraparë objektivat specifikë, gjithnjë duke pasqyruar periudhën e rishikimit të SSHUK. Rrjedhimisht, objektivat strategjike të rishikuara janë:

- **Objektivi Strategjik 1:**
Kompletimi i kuadrit ligjor dhe konsolidimi i kornizës institucionale.
- **Objektivi Strategjik 2:**
Mbrojtja e digave ekzistuese dhe sigurimi afatgjatë i ujit për shfrytëzuesit.
- **Objektivi Strategjik 3:**
Mbrojtja e resurseve ujore dhe mbrojtja nga ujërat duke siguruar mbrojtjen e ekosistemit dhe popullatës.
- **Objektivi Strategjik 4:**
Përmirësimi i besueshmërisë dhe cilësisë së shërbimeve ujore.

4.2 SFIDAT, ORIENTIMET STRATEGJIKE DHE VEPRIMET E PËRGJITHSHME

Iniciativat që duhet të ndërmerren për të arritur objektivat strategjike të vizionit bazohen në këto sfida drejt një të ardhmeje më të mirë ujore.

- ***Menaxhimi i resurseve ujore në mënyrë efikase dhe efektive (duke trajtuar si aspektin sasior ashtu edhe atë cilësor)***

- Rritja e kërkesës për ujë si rezultat i rritjes së popullsisë urbane dhe industrializimit gradual, e shoqëruar më tej nga degradimi i tokës dhe resurseve ujore, tregon nevojën për të menaxhuar në mënyrë efikase dhe efektive resurset ujore.

- ***Lëvizja drejt menaxhimit të integruar të pellgut lumor***

- Pellgu i lumit është një njësi gjeografike me një kufi të mirëpërcaktuar që përcakton tërësinë e procesit hidrologjik dhe i kapërcen kufijtë administrativë por dhe shtetëror. Prandaj është njësi ideale e menaxhimit për të adresuar problemet e ujit.

- ***Përkthimi i ndërgjegjësimit në vullnet dhe kapacitet politik –*** Mos ekzistenca e udhëheqjes së sektorit dhe vullnetit politik, ndër vite, për të zbatuar reformat shumë të nevojshme ka rezultuar në një përkeqësim të cilësisë së ujit, një ulje të disponueshmërisë së ujit dhe konflikte midis përdoruesve (hidrocentrale, amvisëri, industri).

Prandaj, ekziston nevoja për të rrënjosur ndërgjegjësimin mbi vlerën ekonomike, sociale dhe mjedisore të ujit tek politikanët, vendimmarrësit dhe palët e tjera të interesuara në sektorin e ujit.

Objektivi Strategjik 1 – Kompletimi i kuadrit ligjor dhe konsolidimi i kornizës institucionale

Kompletimi i kuadrit ligjor dhe harmonizimi i plotë i tij me legjislacionin përkatës të BE-së (*acquis communautaire*) si dhe definimi i qartë i strukturës institucionale përfshirë edhe konsolidimin e institucioneve përgjegjëse është i domosdoshëm për menaxhimin efektiv dhe të qëndrueshëm të ujërave.

Arritja e këtij objektivi strategjik do të bëhet përmes objektivave specifike: (I) Plotësimi i kornizës ligjore për resurset ujore, (II) Themelimi i Institutit të Ujërave të Kosovës, (III) Rithemelimi i Departamentit të Ujërave, (IV) Përmirësimi i kornizës rregullative për shërbimet e ujit, (V) funksionalizimi i Autoritetit të Rajonit të Pellgjeve Lumore (ARPL) si agjenci ekzekutive, (VI) Zhvillimi institucional i Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës (IHMK), (VII) Fuqizimi i kapaciteteve institucionale në fushën e ujë.

Treguesit dhe caqet kryesore të objektivit strategjik janë:

Treguesit për Objektivin Strategjik 1	Pika fillestare	Caku për vitin 2025	Caku për vitin i 2027
Transpozimi i legjislacionit të BE-së në fushën e ujërave	Rreth 60% ⁸ shkalla e transpozimit	90%	100%
Përforcimi i kapaciteteve në fushën e ujërave	31	62	87

Objektivi Specifik 1.1 Kompletimi i kuadrit ligjor për resurset ujore

Hartimin e ligjit të ri për menaxhimin e resurseve ujore është vlerësuar i nevojshëm dhe tashmë është iniciuar nga MMPHI duke pasur parasysh se ligji aktual, përpos paqartësive dhe kontradiktave që përmban, është i kufizuar në përmbajtje dhe vëllim duke i trajtuar në mënyrë të mangët dhe jo të plotë çështjet që janë objekt i rregullimit të këtij ligji. Kështu që, me ligjin e ri synohet të evitohen këto mangësi të ligjit aktual si dhe të transpozohen konceptet dhe parimet e Direktivës Kornizë për Ujëra (Direktiva e BE 2000/60/EC) që është legjislacioni bazë i KE-së në fushën e menaxhimit të resurseve ujore.

Me qëllim të krijimit të një sistemi të qëndrueshëm të financimit të menaxhimit të ujërave duke i zbatuar parimet bazë për menaxhimin e ujërave '*shfrytëzuesi paguan*' dhe '*ndotësi paguan*' që zbatohen në BE dhe globalisht duhet të hartohet një ligj për financimin e menaxhimit të ujërave.

Përpos ligjeve të mësipërme, gjatë periudhës së ardhshme 5 vjeçare duhet të kompletohet edhe procesi i hartimit akteve nënligjore që dalin nga ligji i ri për menaxhimin e resurseve ujore dhe nga ligji i ri për financimin e menaxhimit të ujërave. Me këto akte nënligjore, planifikohet që të kompletohet plotësisht transpozimi i legjislacionit të BE-së nga fusha e ujërave në legjislacionin kosovar.

Treguesit kryesorë dhe caqet e këtij objektivi specifik janë dhënë në tabelën e mëposhtme:

⁸Sipas vlerësimit të kryer me raportin: ' Legal approximation on chapter 27 Environment, Sub-chapter Water Acquis', 2020, financuar nga German Cooperation dhe zbatuar nga GIZ.

Treguesi për Objektivin Specifik 1.1	Pika fillestare	Caku për vitin 2025	Caku për vitin 2027
Legjislacioni për menaxhimin e resurseve ujore	Ligji ekzistues ka nuk e transpozon DKU	Ligji i ri për Ujëra që transpozon DKU dhe direktivat tjera të ujërave (2024)	
Legjislacioni për financimin e resurseve ujore	Nuk ka	Miratimi i Ligjit për financimin e resurseve ujore (2024)	
Aktet nënligjore për menaxhimin e resurseve ujore	18 UA	25 UA	Përcaktohet me ligjin e ri për ujëra

Objektivi Specifik 1.2 Përmirësimi i kuadrit rregullator për shërbimet e ujit

Me hartimin e ligjit të ri për rregullimin e shërbimeve të ujit duhet të eliminohen disa paqartësi gjatë plotësim-ndryshimit të këtij ligji lidhur me obligimin e pagesës shërbimeve të ujit për objektet e kultit fetar, si dhe do të përfshiheshin disa aspekte ishin rregulluar me akte nënligjore të ARRU.

Për përmirësimin e kuadrit rregullator për shërbimet e ujit (ujësjellësit dhe kanalizimit) është e nevojshme që të rregullohet problematika e zonave të shërbimit të KRU-ve si dhe çështja e certifikimit të personelit të KRU-ve.

Treguesit kryesorë dhe caqet e objektivit specifik janë si vijon:

Treguesi për Objektivin Specifik 1.1	Pika fillestare	Caku për vitin 2025	Caku për vitin 2027
Legjislacioni për zonat e shërbimit të KRU-ve	Mungon akti normativ që i përcakton zonat e shërbimit të KRU-ve	Akt nënligjor i Qeverisë	Licencimi i KRU-ve
Certifikimi i personelit të KRU-ve	Nuk ka bazë ligjore as strukturë institucionale	Baza ligjore për certifikimin e stafit të KRU-ve	Kompletimi i sistemit për certifikimi të stafit të KRU-ve

Objektivi Specifik 1.3 Përforcimi i kapaciteteve inspektuese në fushën e ujërave

Funksioni inspektues është kyç për zbatimin dispozitave ligjore për menaxhimin e resurseve ujore. Me numrin aktual prej 3 inspektorëve të ujërave nuk është e mundur të zbatohet një inspektim efektiv dhe përmbushje të përgjegjësive ligjore që ka inspektorati i ujërave.

Me rritjen e numrit të inspektorëve dhe riorganizimin e shërbimit të inspektimit në bazë të pellgjeve lumore, synohet të arrihet një efikasitet më i lartë në zbatimin e legjislacionit në fushën e ujërave me qëllim të mbrojtjes së lumenjve nga degradimi, ndotja dhe shfrytëzimi i pakontrolluar i ujit.

Treguesit kryesorë dhe caqet e objektivit specifik janë si më poshtë:

Treguesi për Objektivin Specifik 1.1	Pika fillestare	Caku për vitin 2025	Caku për vitin 2027
Rritja e numrit të inspektorëve të ujërave dhe riorganizimi i punës së inspektimit		3	8

Objektivi Strategjik 2 - Sigurimi afatgjatë i ujit për shfrytëzuesit dhe siguria e digave ekzistuese

Duke pasur parasysh resurset e kufizuara ujore që ka Kosova si dhe shkallën e ulët të akumulimit të resurseve ujore, zhvillimi i resurseve të reja që nënkupton ndërtimin e akumulimeve të reja të ujërave, sidomos për pellgjet e Ibrit, Moravës së Binçës dhe Lepencit është parakusht bazik për zhvillimin e vendit. Gjithashtu, siguria e digave ekzistuese është e ndërlidhur me sigurinë e ujit që akumulojnë ato po edhe me sigurinë e njerëzve dhe pasurisë që janë në zonat nën diga.

Treguesit kryesorë dhe caqet e objektivit specifik janë:

Treguesi për Objektivin Strategjik 2	Pika fillestare	Caku për vitin 2025	Caku për vitin 2027
Kapacitetet akumuluese	559 mil. m ³ /(2021)	559 mil. m ³	575 mil / m ³

Arritja e këtij objektivit strategjik planifikohet të bëhet përmes objektivave specifike:

Objektivi Specifik 2.1 Siguria dhe monitorimi i rregullt i digave ekzistuese

Gjashtë digat e larta që janë në Kosovë (Ujmani, Radoniqi, Batllava, Badovci, Përlepnicë dhe Livoçi) janë ndërtuar para më se 40 vjetësh dhe aktualisht katër prej tyre menaxhohen nga KRU-të (Batllava dhe Badovci nga KRU Prishtina, Radoniqi nga KRU Gjakova, dhe Përlepnicë nga KRU Hidromorava), një (Ujmani) nga Ndërmarrja "Ibër-Lepenc", dhe njëra (Livoçi) nuk menaxhohet fare. Për shkak të rëndësisë së këtyre digave, madhësisë së tyre dhe rrezikut që kanë në rast të ndonjë shkatërrimi të mundshëm, është e domosdoshme të këtë një kujdes dhe monitorim sistematik dhe të vazhdueshëm të trupit të digave si dhe i elementeve të tjerë konstruktiv të tyre.

Bazuar në vlerësimin e fundit (2021) të financuar nga MMPHI për sigurinë e 5 digave të mëdha (Ujman, Radoniq, Batllavë, Badovc dhe Përlepnicë) ka rezultuar domosdoshmëria e furnizimit dhe instalimit të sistemeve bashkëkohore të monitorimit të këtyre digave siç janë: sistemet e monitorimit gjeodezik, hidrometeorologjik, sizmik, gjeologjik dhe hidrogjeologjik, hidroteknik, si dhe mbledhjes dhe përpunimit automatik të të dhënave. Në ndërkohë është bërë edhe studimi i sigurisë së digës së Livoçit me financim nga Banka Botërore. Duhet të instalohen sistemet e monitorimit të digës, të kryhen matjet e duhura sa më shpejtë. Struktura e digës, konkretisht betonet, duhet t'i nënshtrohen një analize të hollësishme të gjendjes së tyre, fortësisë dhe markës aktuale, amortizimit të mundshëm, filtrimeve në zonën e fugave ndërmjet blloqeve, etj. Po ashtu duhet të kryhen matjet batimetrike dhe të përcaktohen volumet aktuale të ujit, të kryhet një analizë e sedimentit të rezervuarit, të riparohet sistemi i ujëlëshuesit dhe puseta në zonën poshtë digës, si dhe të instalohen sistemi i alarmit dhe të përgatiten planet e gatishmërisë në rastet e emergjencës civile.

Diga e Livoçit ka mbetur pa titullar. Me rehabilitimin e digës, Gjilani do të ketë edhe një resurs ujor në dispozicion, që do të mund të përdorej për ujë të pijes dhe ujitje, ndonëse për një sipërfaqe të vogël, por duhet të vendoset kujt me ia dhënë në menaxhim këtë digë.

Administrimi i digës nga një titullar, në krahasim me braktisjen e përdorimit të kësaj dige, do të rrisë sigurinë e digës dhe rrjedhimisht vendbanimeve poshtë digës.

Treguesit kryesorë dhe caqet e objektivit specifik janë si vijon:


Treguesi për Objektivin Specifik 2.1	Pika fillestare	Caku për vitin 2025	Caku për vitin 2027
Monitorimi i sigurisë së digave	0	Pajisjet për monitorim të instaluara	6

Objektivi Specifik 2.2 Zhvillimi i resurseve të reja ujore

Duke qenë se problemi i resurseve të pakta ujore është veçanërisht i theksuar në pjesën e Kosovës qendrore dhe lindore, fokusi në fazën e parë do të vendoset në zhvillimin e resurseve ujore në këtë pjesë të Kosovës. Ndërtimi i digës së Firajës për qëllim të akumulimit të ujit në lumin Lepenc do të zgjidhte problemet aktuale të furnizimit me ujë të popullatës dhe ekonomisë për komunat e Ferizajt, Gjilanit, Kaçanikut dhe Vitisë (fig. 7.a). Me fazën e dytë të këtij projekti do të ndërtohej diga dhe akumulimi më i madh (66 mil. m³) në Shtime me qëllim të përmbushjes së nevojave për ujitje për Kosovën jugore dhe qendrore dhe gjithashtu do të mundësohej siguria e ujit për nevoja të industrisë që furnizohet nga sistemi Ibër (fig. 7.b). Me këtë akumulim po ashtu do të gjenerohej edhe energji elektrike.

Treguesit kryesorë dhe caqet e objektivit specifik janë si vijon :

Treguesi për Objektivin Specifik 2.2	Pika fillestare	Caku për vitin 2025	Caku për vitin 2027
Ndërtimi i digës së Firajës	0	0	9 mil. m ³
Ndërtimi i digës në komunën e Kamenicës	0	0	6 mil. m ³
Ndërtimi i digave tjera: Pollata, Kuçica dhe Dragaqina.	0	0	Varësisht prej gjetjeve të studimit të fizibilitetit



Me ndërtimin e digës dhe akumulimit në komunën e Kamenicës do të lehtësoheshin presionet e mungesës së ujit dhe përkeqësimit të kushteve për shkak të thatësisë së shkaktuar nga ndryshimet klimatike në pellgun verior të Moravës së Binçës. Për këtë qëllim, përmes projektit të financuar nga Banka Botërore (BB) “Nxitja dhe Levimi i Mundësive për Sigurinë e Ujit” (i njohur me akronimin FLOWS, në anglisht – Fostering and Leveraging Opportunities

for Water Security) i ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me ligjin nr. 08/L-096 do të përditësohet analiza në shumë aspekte, duke përfshirë nga një këndvështrim teknik, social dhe mjedisor në përputhje me bazën aktuale, kërkesat dhe objektivat si dhe do të përzgjidhet opsioni optimal (prej disa opsioneve që janë duke u konsideruar aktualisht – Kremenata, Desivojca, Shipashnica, shih fig.8).




Figura 8: Ujëmbledhësit e tri digave të mundshme në Kamenicë, Studimi i fizibilitetit Projekti FLOWS 2021

Përmes projektit FLOWS gjithashtu do të përgatitet një studim i përditësuar dhe i detajuar mbi Investimet për Resurset e Reja Ujore në nivel nacional, duke përfshirë një Vlerësim Strategjik Mjedisor dhe Social (VSMS) si dhe vlerësimin e skenarëve për mundësitë e investimit. Kjo do të përditësojë pjesën e digave të Masterplanit të vitit 1983, si dhe do të ndihmojë zhvillimin e PMPL-ve duke siguruar që këto plane t'i përgjigjen sfidave të gjera të sigurisë së ujit të vendit.

Objektivi Strategjik 3 – Mbrojtja e resurseve ujore dhe mbrojtja nga ujërat duke siguruar mbrojtjen e ekosistemit dhe popullatës

Rregullimi dhe mbikëqyrja e aktiviteteve që bëjnë presion në mjedisin ujorë në mënyrë proporcionale, efiçente dhe efektive është e domosdoshme për arritjen e objektivave mjedisore në mënyrë të arsyeshme ekonomike për trupat e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe në të njëjtën kohë për respektimin e parimeve të menaxhimit të qëndrueshëm.

Mbrojtja efektive e ujërave kërkon aplikimin e një sistemi të kontrollit ku shkarkimet në ujëra, apo aktivitetet tjera që mund të kenë efekt negativ në cilësinë e ujit l nënshtrohen një autorizimi paraprak, monitorimit dhe detyrimit të zbatimit.

Treguesit kryesorë dhe caqet e objektitivit specifik janë si më poshtë:

Treguesi për Objektivin Strategjik 3	Pika fillestare	Caku për vitin 2025	Caku për vitin 2027
Shkalla e trajtimit të ujërave të ndotura urbane	8% të popullatës kanë qasje në sistemet e kanalizimit që trajtojnë ujërat e ndotura.	20% e popullatës	35% e popullatës

Objektivi Specifik 3.1 Hartimi i Planeve të Menaxhimit të Pellgjeve Lumore

Planet e menaxhimit të pellgjeve lumore (PMPL) janë dokumentet bazë planifikuese për menaxhimin e pellgjeve lumore të përcaktuara si të tilla me direktivat e BE-së dhe me legjislacionin Kosovar. Përmbajtja e këtyre planeve si dhe çështje tjera për përgatitjen e tyre si, afati kohor, dinamika kohore për përgatitjen e tyre, procesi i konsultimit dhe diskutimit publik janë përcaktuar me Ligjin për Ujërat e Kosovës. Objektivat mjedisore që duhet të arrihen sikurse edhe programi i masave për arritjen e tyre janë pjesë përbërëse të këtyre planeve.

Me hartimin e PMPL-ve dhe zbatimin e programit të masave që duhet të jenë pjesë e tyre, do të synohet përmirësimi i statusit të ujërave – së paku në status i mirë - në pajtim me objektivat mjedisore, në pajtim me standardet e BE-së.

PMPL për pellgun e Lumit Drini i Bardhë aktualisht është në finalizim së bashku me ARPL dhe pritet të dorëzohet në fund të nëntorit 2023. PMPL është përditësuar, në disa kapituj, si p.sh. identifikimi dhe priorizimi i çështjeve të rëndësishme të menaxhimit të ujit që ishin identifikuar fillimisht në vitin 2018, monitorimi i ujërave sipërfaqësore, vlerësimi i ndikimit, analiza ekonomike, programin e masave dhe kostot.

Zhvillimi i tre PMPL-ve të Ibrit, Moravës së Binçës dhe Lepencit është duke u zhvilluar dhe planifikohet të kompletohen deri në vitin 2024.

Treguesit kryesorë dhe caqet e objektivit specifik janë si më poshtë:

Treguesit për Objektivin Specifik 3.1	Pika fillestare	Caku për vitin 2025	Caku për vitin 2027
Planet e Menaxhimit të Pellgjeve Lumore (PMPL)	Mungojnë	PMPL për 4 pellgjet lumore	Zbatimi

Objektivi Specifik 3.2 Kompletimi i rrjetit të monitorimit të ujërave nëntokësore

Përmes monitorimit të 20 puseve të hapura me mbështetjen e Qeverisë Suedeze në vitin 2019 (fig. 9), si dhe 20 puseve të rehabilituara përmes këtij projekti (6 në pellgun e Ibrit, si dhe 8 në pellgun e Moravës së Binçës dhe 6 në Lepenc) do të këtë informacione të duhura për gjendjen ekzistuese të ujërave nëntokësore (sasinë dhe cilësinë) që janë të domosdoshme për vlerësimin e statusit të këtyre ujërave dhe për shfrytëzimin e tyre të qëndrueshëm. Rrjeti i monitorimit pritet të kompletohet deri në mesin e vitit 2023 dhe të bartet tek IHMK.




Figura 9. Trupat ujqor nëntokësor dhe pikat e monitorimit në pellgun e Drinit të Bardhë, Plani i Menaxhimit të Pellgut Lumor Drini i Bardhë.

Treguesit kryesorë dhe caqet e objektivit specifik janë si më poshtë:

Treguesit për Objektivin Specifik 3.2	Pika fillestare	Caku për vitin 2025	Caku për vitin 2027
Kompletimi i rrjetit të monitorimit të ujërave nëntokësorë	Mungon (funktionalizimi)	Përmirësimi i matjeve hidrometrike, instalimi i pajisjeve dhe punime të vogla civile	Sipas vlerësimit të IHMK.

Objektivi Specifik 3.3 Mbrojtja e lumenjve nga eksploatimi i pakontrolluar i aluvioneve dhe nga ndotja me mbeturina

Problemi i degradimit të lumenjve si pasojë e shfrytëzimit të aluvioneve (inerteve) është konstatuar në raportet e shumta : ([https://www.ammk-rks.net/Raporti-Ndikimi i shfrytëzuesve të rërës dhe zhavorit në gjendjen mjedisore të lumenjve 2022\(alb\).pdf](https://www.ammk-rks.net/Raporti-Ndikimi%20i%20shfrytëzuesve%20të%20rërës%20dhe%20zhavorit%20në%20gjendjen%20mjedisore%20të%20lumenjve%202022%20%28alb%29.pdf)). Duke pasur parasysh efektet jashtëzakonisht negative afatshkurta dhe afatgjata nga kjo dukuri dhe faktin që masat e deritashme nuk kanë dhënë efekt të mjaftueshëm, kjo problematikë planifikohet të rishikohet në tërësi si në aspektin rregullativ / ligjor dhe në veçanti në planin zbatues në mënyrë që të vendoset një sistem efikas që parandalon degradimin e mëtutjeshëm të ujërave.

Në mungesë të një qasje sistematike për parandalimin e ndotjes së lumenjve me mbeturina, si dhe në mungesë të veprimit institucional për arsye të mungesës së stafit qoftë në at nivel lokal dhe qendror, e qoftë edhe nga organet e drejtësisë duhet të kërkohet një qasje më proaktive dhe permanente. I tërë fokusi duhet të përqendrohet në pastrimin e lumenjve dhe trajtimi i këtij fenomeni së bashku me menaxhimin e eksploatimit të shtretërve dhe brigjeve të lumenjve do të ishte arritje e madhe në mbrojtjen e resurseve ujore.

Treguesit kryesorë dhe caqet e objektivit specifik janë si:

Treguesit për Objektivin Specifik 3.3	Pika fillestare	Caku për vitin 2025	Caku për vitin 2027
Inspektimet për kontrollin e eksploatimit të aluvioneve	Veprim minimal	Rritja për 30%	Rritja për 50%

Objektivi Specifik 3.4 Trajtimi i ujërave të ndotura urbane

Përpos impianteve në 5 komunat e Kosovës që tashmë janë kompletuar dhe në funksion – Pejë, Prizren, Gjakovë, Skenderaj dhe Junik, në periudhën e ardhshme 5-vjeçare do të vazhdohet me aktivitet dinamik për ndërtimin e impianteve të reja në komunat e Kosovës. Me ITUN rajonal për komunat Prishtinë, Obiliq, Fushë Kosovë dhe Graçanicë do të trajtohen ujërat e ndotura të sistemit që mbulon rreth 400 mijë banorë duke kontribuar kështu në përmirësimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe ruajtjen e mjedisit.

Përpos ITUN për rajonin e Prishtinës, gjatë periudhës së ardhshme 5 vjeçare planifikohen ndërtimi i impianteve për rajonin e Mitrovicës (Mitrovicë, Vushtrri, Mitrovicë Veriore dhe Zveçan), pastaj për Gjilanin, Podujevën dhe Ferizaj si dhe të hartohen studimet e fizibilitetit për komunat Vushtrri, Malishevë, Drenas, Lipjan, Rahovec, Therandë, Viti, Istog, Deçan, Klinë dhe Kamenicë.

Me trajtimin e ujërave të ndotura urbane të këtyre komunave, përpos përmbushjes së obligimit ligjor për mbrojtjen e ujërave dhe përmirësimin e statusit të resurseve ujore, adresohet edhe problemi i mbrojtjes së ujërave ndërkufitare. Meqë të gjitha ujërat e Kosovës janë të karakterit ndërkufitar, me trajtimin e ujërave të ndotura Kosova i zbaton parimet e të drejtës së pellgjeve ndërkufitare.

Treguesit kryesorë dhe caqet e objektivit specifik janë si në vijim:

Treguesit për Objektivin Specifik 3.4	Pika fillestare	Caku për vitin 2025	Caku për vitin 2027
Numri i qyteteve me trajtim të ujërave të ndotura (ITUN)	5	10	16

Objektivi Specifik 3.5 Mbrojtja e ujërave nga ndotja prej shkarkimit të ujërave industriale

Ndër ndotësit më të mëdhenj të ujërave janë shkarkimi i patrajtuar i ujërave industriale në lumenjtë e Kosovës, ndonëse me legjislacion janë përcaktuar vlerat kufizuese të shkarkimeve të ujërave të ndotura industriale në trupat ujqor, respektimi i të cilave është obligator. Megjithatë, zbatimi i kësaj dispozite në praktikë është i mangët për mungesë të numrit të stafit në institucionet përgjegjëse.

ARPL në bashkëpunim me AMMK, IHMK, MINT, KRU-të dhe komunat, dhe me përkrahje të programeve të donatorëve, p.sh. MIRU-K, duhet të evidentojë të gjithë ndotësit industrial dhe llojin e industrisë në një kadastër të ndotësve dhe pastaj të zbatohen kërkesat e legjislacionit për trajtimin e ujërave të ndotura industriale para shkarkimit të tyre në mjedisin ujqor apo në kanalizimin publik. Në këtë mënyrë do të ndikohet në ruajtjen e cilësisë së ujit në trupat ujqorë.

Treguesit kryesorë dhe caqet e objektivit specifik janë si në vijim:

Treguesit për Objektivin Specifik 3.5	Pika fillestare	Caku për vitin 2025	Caku për vitin 2027
Shkalla e trajtimit të ujërave të ndotura industriale para shkarkimit në ujërrjedha	Zbatim i papërfillshëm	20%	50%
Shkalla e paratrajtit të ujërave të ndotura industriale para shkarkimit në kanalizimin publik	Zbatim i papërfillshëm	30%	80%

Objektivi Specifik 3.6 Shpallja e zonave erozive

Institucionet përgjegjëse (MMPHI dhe komunat) janë të obliguara që të përcjellin në vazhdimësi gjendjen e proceseve erozive dhe shtretërve të rrëkeve dhe objekteve për mbrojtje nga erozion, objekte këto që nuk janë të evidentuara qysh nga periodha e pasluftës. Po ashtu duhet të sigurojnë mirëmbajtjen e rregullt të këtyre objekteve dhe sipërfaqeve në zonat erozive, dhe riparimin e dëmtimeve të shkaktuara nga ndikimet natyrore dhe antropogjene. ARPL me përkrahje të jashtme duhet të evidentojë zonat erozive dhe masat dhe veprimet për mbrojtjen nga erozioni, dhe t'ia përgatis vendimet për shpalljen e zonave erozive Ministrit.

Treguesit kryesorë dhe caqet e objektivit specifik janë si në vijim:

Treguesit për Objektivin Specifik 3.6	Pika fillestare	Caku për vitin 2025	Caku për vitin 2027
Shpallja e zonave erozive	Mungon	Identifikimi i zonave erozive	Shpallja e zonave erozive

Objektivi Specifik 3.7 Menaxhimi i përmytjeve

Pas hartimit të Vlerësimit Preliminar të Rrezikut nga Përmytjet dhe identifikimit të Zonave me rrezik potencial të konsiderueshëm nga përmytjet (fig. 10) për çdo pellg lumor, dhe pas hartimit të Hartave të Rrezikshmërisë dhe Hartave të Rrezikut nga Përmytjet (të cilat kanë filluar të përpilohen në qershor 2022 dhe planifikohet të kompletohen në shkurt 2024), do të aplikohet për hartimin e planeve të menaxhimit të përmytjeve. Me kompletimin e këtyre hartave do të përmbushen obligimet ligjore të përcaktuara me legjislacionin e ujërave e që janë në përputhje me legjislacionin Evropian. Gjithashtu, me këto harta do ketë më shumë informacion mbi masat që do të ndërmerren për reduktimin e ndikimeve të dëmshme dhe pasojave të përmytjeve në shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik dhe veprime për të reduktuar mundësinë e shfaqjes së përmytjeve.

Treguesit kryesorë dhe caqet e objektivit specifik janë si në vijim:

Treguesit për Objektivin Specifik 3.7	Pika fillestare	Caku për vitin 2025	Caku për vitin 2027
Planet e menaxhimit të rrezikut nga përmytjet	0	0	4




Figura 10: Zonat me rrezik potencial të konsiderueshëm nga përmbytjet në pellgjet e lumenjve të Kosovës, Vlerësimi preliminar i Projektit të COVI-WBIF 2020.

Objektivi Specifik 3.8 Mbrojtja e burimeve të ujit të pijshëm

Mbrojtja e burimeve të ujit të cilat shfrytëzohen për furnizim me ujë të pijshëm, qoftë atyre sipërfaqësore apo nëntokësore, është me rëndësi vitale për parandalimin e ndotjes së tyre dhe rrjedhimisht për mbrojtjen e shëndetit të popullatës që furnizohet me ujë nga ato burime. Kjo mbrojtje përgjithësisht realizohet përmes përcaktimit të zonave mbrojtëse përreth burimeve dhe përkufizimit të masave konkrete me të cilat ndalohen apo kufizohen veprimtari të caktuara të cilat mund të ndikojnë në ndotjen e këtyre burimeve.

Treguesit kryesorë dhe caqet e objektit specifik janë:

Treguesit për Objektivin Specifik 3.8	Pika fillestare	Caku për vitin 2025	Caku për vitin 2027
Përcaktimi i zonave të mbrojtura me vendim të Qeverisë për burimet e ujit të cilat nuk i kanë të përcaktuara zonat e mbrojtura.	35	40	45

Objektivi Specifik 3.9 Rregullimi dhe mbikëqyrja e shfrytëzimit të ujërave për qëllime afariste

Shfrytëzimi i ujërave për qëllime afariste deri tash është bërë pa zbatuar procedurën e koncesionit. Ky i fundit nënkupton një proces konkurrues dhe transparent siç parashihet me Ligjin për Ujërat e Kosovës.

Dhënia me koncesion në shfrytëzim të ujërave për qëllime afariste para së gjithash ka të bëjë me zbatimin e ligjit. Kjo bëhet përmes një konkursi kompetitiv publik, dhe në rastet ku shfrytëzimi bëhet në tokë private, përmes dhënies së koncesionit direkt. Gjithashtu, zbatimi i koncesionit për shfrytëzim afarist të ujërave është në pajtim me praktikën e mira që zbatohen në vendet e rajonit dhe BE-së. Në veçanti, është me rëndësi të theksohet synimi që të ndalohet praktika e kaluar e lejimit të ndërtimit të hidrocentraleve të vogla të cilat janë ndërtuar pa respektuar legjislacionin mjedisor dhe dokumentet planifikuese në fushën e ujërave duke shkaktuar kështu dëme të konsiderueshme mjedisore si rezultat i këtyre ndërtimeve dhe tejshfrytëzimit të ujërave.

Treguesit kryesorë dhe caqet e objektivit specifik janë si:

Treguesit për Objektivin Specifik 3.9	Pika fillestare	Caku për vitin 2025	Caku për vitin 2027
Shkalla e zbatimit të koncesionit si instrument ligjor i dhënies së të drejtës ujore për shfrytëzim afarist të ujit.	0	30%	50%

Objektivi Strategjik 4 – Përmirësimi i besueshmërisë dhe cilësisë së shërbimeve ujore

Përmes konsolidimit institucional, rritjes së llogaridhënies së bordeve dhe menaxhmentit, zvogëlimit të humbjeve të ujit, dhe përmirësimit të performancës operative dhe financiare, KRU-të do të rrisin efikasitetin e tyre dhe do të zhvillojnë kapacitetet financiare të nevojshme për rritjen substanciale të investimeve në mirëmbajtjen dhe zgjerimin e bazës së aseteve në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit që ofrojnë për konsumatorët.

Treguesit kryesorë dhe caqet e objektivit specifik janë:

Treguesit për Objektivin Strategjik 4	Pika fillestare	Caku për vitin 2025	Caku për vitin 2027
Përqindja e popullatës që furnizohet me ujë 24/7 nga sistemet e ujësjellësit të menaxhuara nga KRU-të	94%	96%	100%
Shkalla e përputhshmërisë me standardet e cilësisë së ujit të pijshëm.	98%	99%	99.5%
Përqindja e popullatës që furnizohet me ujë nga sistemet që menaxhohen nga KRU-të	79%	85%	90%

Objektivi specifik 4.1 Përmirësimi i furnizimit me ujë në zonat urbane

Problemet aktuale sa i përket furnizimit me ujë në disa prej komunave të Kosovës janë iniciuar tashmë dhe synohet të zgjidhen gjatë 3-5 viteve të ardhshme.

Problemi i furnizimit me ujë në Ferizaj dhe Gjilan do të zgjidhet në mënyrë afatgjatë përmes akumulimit të Firajës.

Në këtë mënyrë do të sigurohet stabilitet i furnizimit me ujë për këto dy komuna të cilat kanë kapacitete të pamjaftueshme të resurseve ujore kundrejt kërkesave për ujë – atyre aktuale dhe të ardhshme. Përpos shtimit të sasisë së ujit, duhet të bëhet edhe rritja e kapacitetit aktual të trajtimit të ujit për këto dy komuna.

Me qëllim të zgjidhjes afatgjate dhe të qëndrueshme të problemit të furnizimit me ujë për nevoja të popullatës, institucioneve dhe ekonomisë së komunës së Malishevës planifikohet të hartohet një studim që do të përfshinte hulumtimin e resurseve ujore në komunën e Malishevës si dhe alternativat e burimeve të ujit të cilat mund të shfrytëzohen për furnizim me ujë (burimi i Bajës, etj.).

Zgjidhja e problemit të gjatë me të cilin ballafaqohet komuna e Klinës sa i përket cilësisë së ujit me të cilin furnizohet kjo komunë do të bëhet përmes rehabilitimit të impiantit ekzistues të ujit të pijshëm duke përfshirë ndërtimin e objektit për zvogëlimin e turbiditetit të ujit nga pusët dhe ndërrimin e filtrave.

Me hartimin e studimit të fizibilitetit për furnizim me ujë të komunës së Mamushës do të adresohet problemi i cilësisë së ujit me të cilin furnizohet popullata e kësaj komune. Me këtë rast do të konsiderohen disa alternativa (trajtimi i ujit nga pusët e Novakës, furnizimi me ujë nga Prizreni, furnizimi me ujë nga Liqeni i Radoniqit) dhe bazuar në kosto-efektivitetin e këtyre alternativave të përzgjidhet opsioni më i mirë për zgjidhjen afatgjatë dhe të qëndrueshme të problemit të furnizimit me ujë të Mamushës.

Treguesit kryesorë dhe caqet e objektivit specifik janë si më poshtë:

Treguesit për Objektivin Specifik 4.1	Pika fillestare	Caku për vitin 2025	Caku për vitin 2027
Numri i komunave që kanë probleme në furnizimin me ujë si rezultat i kapaciteteve të pamjaftueshme të burimeve ujore	8 (Malisheva, Klina, Ferizaji, Prishtina, Gjilani, Vitia, Kamenica, Mamusha)	4 (Prishtina, Ferizaji, Gjilani, Vitia)	0

Objektivi specifik 4.2 Përmirësimi i furnizimit me ujë në zonat rurale

Integrimi nën menaxhim të KRU-ve i sistemeve rurale të paintegruara⁹ (fig. 11) vlerësohet të jetë zgjidhje që siguron qëndrueshmërinë afatgjatë të këtyre sistemeve. Vetëm në këtë mënyrë mundësohet operim dhe mirëmbajtje adekuate e këtyre sistemeve, investime sistematike në rehabilitim dhe përtëritje të aseteve, monitorim i cilësisë së ujit etj.

⁹ Një raport i "Programi Mbështetës për Sistemet e Ujësjellësit dhe Kanalizimit në Zonat Rurale në Kosovë" i bashkëfinancuar nga Qeveria Zvicerane dhe ajo e Kosovës, ka vlerësuar se një numër i konsiderueshëm i sistemeve rurale nuk janë nën menaxhim të KRU-ve. Nga këto sisteme të ujësjellësit furnizohen rreth 12% e popullatës që kanë qasje në sistemet publike të ujësjellësit. Këto sisteme janë kryesisht në komunën e Dragashit, rajonin e Zhupës (komuna e Prizrenit), komuna e Shtërpçës dhe komunat e vogla të rajonit të Anamoravës.




Figura 11. Menaxhimi i sistemeve rurale të ujësjellësit

Me integrimin e sistemeve rurale në KRU arrihet përmirësimi i efikasitetit të kostos dhe të sigurimit të qëndrueshmërisë financiare, operuesit e sistemeve rurale dhe komunale të furnizimit me ujë për të qenë në gjendje të ofrojnë cilësi më të mirë të shërbimeve, menaxhim dhe kontroll më të mirë.

Treguesit kryesorë dhe caqet e objektivit specifik janë si më poshtë:

Treguesit për Objektivin Specifik 4.2	Pika fillestare	Caku për vitin 2025	Caku për vitin 2027
Përqindja e popullatës që furnizohet me ujë prej sistemeve të ujësjellësit të cilat nuk menaxhohen nga KRU-të	13%	8%	3%

Objektivi Specifik 4.3 Zvogëlimi i humbjeve të ujit nga sistemet publike të ujësjellësit

KRU-të duhet t'i hartojnë planet për zvogëlimin e humbjeve të ujit në të cilat duhet të përfshihen në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të detajuar aktivitetet për zvogëlimin e humbjeve të ujit përfshirë edhe kostot përcjellëse. Këto plane duhet të diskutohen dhe të miratohen nga Bordet e KRU-ve por edhe nga ARRU. Planet për zvogëlimin e humbjeve të ujit do të duhej të jenë për periudhë 3-vjeçare në mënyrë që të korrespondojnë me ciklin e procesit tarifar që e zbaton ARRU.

Arritja e progresit të duhur në zvogëlimin e humbjeve të ujit në përputhje me planet e KRU-ve do të mbikëqyret nga Qeveria e Kosovës si aksionar i këtyre ndërmarrjeve, në baza vjetore përmes mekanizimit të vlerësimit të performancës. Kjo mbikëqyrje do të zbatohet bazuar në raportet e ARRU. Për arritjen respektivisht mosarritjen e caqeve të përcaktuara, do të vepohet në pajtim me përcaktimet ligjore.

Treguesit kryesorë dhe caqet e objektivit specifik janë si më poshtë:

Treguesit për Objektivin Specifik 4.3	Pika fillestare	Caku për vitin 2025	Caku për vitin 2027
Zvogëlimi i humbjeve të ujit	55%	50%	46%

Objektivi Specifik 4.4 Përmirësimi i besueshmërisë së operimit të kanalizimit të ujërave të ndotura

Me investimet në rrjetin e kanalizimit të komunës së Prishtinës dhe komunave tjera të kësaj zone Fushë Kosovë, Obiliq dhe Graçanicë, në vlerë prej 71 milion € investime nga Banka Gjermane për Zhvillim (KfW), BE dhe komunat përfituese, do të rehabilitohet rrjeti i kanalizimit dhe do të ndërtohet kolektori kryesor që transporton ujërat e ndotura të kanalizimit deri te ITUN.

Në këtë mënyrë do të optimizohet puna e ITUN dhe do të sigurohet funksionimi i duhur i sistemit të kanalizimit të ujërave të ndotura dhe ujërave atmosferike.

Gjithashtu, me investimet në rehabilitimin e rrjetit të kanalizimit në 3 komunat e Kosovës Jugperëndimore (Pejë, Gjakovë dhe Prizren) do të ndahen sistemi i ujërave atmosferike nga ai i ujërave të ndotura dhe kështu do të mundësohet funksionimi pa probleme dhe optimal i ITUN në këto komuna.

Treguesit kryesorë dhe caqet e objektivit specifik janë si më poshtë:

Treguesit për Objektivin Specifik 4.4	Pika fillestare	Caku për vitin 2025	Caku për vitin 2027
Përqindja e popullatës e mbuluar me shërbime të kanalizimit që menaxhohen nga KRU-të	65%	70%	77%

Objektivi Specifik 4.5 Menaxhimi i llumit të ujërave të ndotura

Procesi dinamik i ndërtimit të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura ka për pasojë gjenerimin e një sasive të konsiderueshme të llumit si produkt i procesit të trajtimit.

Sasitë e llumit do të jenë të konsiderueshme dhe, rrjedhimisht, duhet të gjendet zgjidhja më e mirë për atë se çka të bëhet me këtë llum. Teorikisht, janë të mundshme opsionet si vijon: (i) shfrytëzimi i llumit për plehërimin e tokave bujqësore me kusht që ky llum paraprakisht të trajtohet, (ii) deponimi i këtij llumi në deponi, (iii) djegia e llumit.

Të gjitha këto alternativa duhet të analizohen në kuptim të fizibilitetit të tyre dhe kosto-përfitimeve dhe të rekomandohet një program për menaxhimin e llumit në nivel të Kosovës.

Pas analizimit të opsioneve të largimit të llumit, duhet të synohet zvogëlimi i llumit që deponohet në deponi konform trendeve dhe objektivave të vendeve të BE-së.

Treguesit kryesorë dhe caqet e objektivit specifik janë si më poshtë:

Treguesit për Objektivin Specifik 4.5	Pika fillestare	Caku për vitin 2025	Caku për vitin 2027
Përqindja e llumit të kanalizimit që deponohet në deponi	100%	95%	70%

Për arritjen e këtij objektivit specifik do të ndërmerren veprimet si vijon:

- ▶ Hartimi i planeve të menaxhimit të llumit të ujërave të ndotura;
- ▶ Hartimi i programit për menaxhimin e llumit të ujërave të ndotura;
- ▶ Ndërtimi i inceneratorit për rajonin e Prishtinës.

5. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

MMPHI është përgjegjëse për onitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të kësaj Strategjie si dhe që, sipas nevojës, të ndërmarr veprime për të siguruar zhvillimin me kohë dhe në mënyrë efektive të aktiviteteve të përcaktuara në planin e veprimit.

Funksionet kryesore të MMPHI në procesin e monitorimit dhe raportimit janë si në vijim:

- Të krijojë një mekanizëm efektiv monitorimi dhe raportimi në përputhje me kërkesat e onitorimit dhe raportimit dhe të sigurojë zbatimin e tij.
- Të mbledh informacion nga ministritë pjesëmarrëse për zbatimin e dokumentit strategjik dhe planit të tij të veprimit.
- Të përgatis raportet e rregullta vjetore mbi zbatimin e dokumentit strategjik dhe raportin gjashtëmuor për zbatimin e planit të veprimit.
- Të organizojë punën e organit ndërministror të koordinimit, për të cilin ato ofrojnë funksione të sekretariatit.
- Të nis diskutimet për çështje problematike, nëse është e nevojshme.
- Të publikojë raporte të rregullta në faqen e internetit të ministrisë pas miratimit të tyre nga organi përkatës.

Me qëllim të zbatimit efektiv dhe cilësor të mbikëqyrjes, me propozim të MMPHI do të krijohet një grupi koordinues ndërministror i përbërë nga përfaqësuesit e:

- (1) MMPHI,
- (2) KNU,
- (3) MFPT,
- (4) ME,
- (5) MBPZHR,
- (6) Zyrës së Planifikimit Strategjik
- (7) SHUKOS.

Organi koordinues ndërministror do të kryesohet nga ministria përgjegjëse për zbatimin e strategjisë.

Grupi koordinues ndërministror për monitorimin e zbatimit të Strategjisë do të takohet në baza 6-mujore, e sipas nevojës edhe më shpesh.

Raportet për zbatimin e planit të veprimit do të përgatiten çdo gjashtë muaj. Këto raporte duhet të përmbajnë: progresin e arritur, arsyet për vonesa, rreziqet që lidhen me zbatimin e veprimeve dhe hapat e ardhshëm.

Në fund të periudhës pesëvjeçare, grupi koordinues ndërministror, do të vlerësojë përmbushjen e objektivave të Strategjisë dhe për këtë do të përgatis raport. Raporti i vlerësimit të zbatimit duhet t'iu përmbahet udhëzimeve të *Manualit për Planifikimin, Hartimin dhe Monitorimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të tyre të Veprimit*.

6. NDIKIMI BUXHETOR I ZBATIMIT TË STRATEGJISË

Planifikimi financiar për zbatimin e Strategjisë Shtetërore të Ujërave të Kosovës 2023-2027 synon realizimin e objektivave strategjike dhe objektivave specifike të planifikaura me dokumentin në fjalë dhe menaxhimin më efektiv të resurseve ujore për sigurimin e sasisë së ujit dhe cilësinë e tij të duhur, për nevojat e popullatës dhe të zhvillimit ekonomik.

Ndikimi buxhetor dhe aspekti financiar i zbatimit të Strategjisë Shtetërore të Ujërave të Kosovës 2023-2027 është diskutuar gjatë punës dhe konsultimeve të grupit punues, shqyrtimit dhe analizimit të dokumenteve: “ Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021 – 2025”, “Planit Strategjik dhe Operacional 2021-2025 i Qeverisë së Republikës së Kosovës”; “ Korniza Afatmesme Buxhetore 2021-2024” dhe projekteve që janë financuar nga organizatat donatore.

Pjesa më e madhe e kostos (rreth 90% e buxhetit) do të përdoret për projekte që do të sigurojnë menaxhimin e resurseve ujore që janë: mbrojtja e ujërave, mbrojtja nga veprimet e dëmshme të ujërave dhe shfrytëzimi më eficient i ujërave.

Vlera e përgjithshme e zbatimit të SSHKU-së 2023-2027 është llogaritur të jetë vetëm për periudhën e parë tri vjeçare do të nevojiten 181,294 261.96 EURO. Gjatë kësaj periudhe, Buxheti i Republikës së Kosovës llogaritet të ketë ndikim me 16,377.261.96 Euro.

Zbatimi i SSHKU-së 2023-2027 do të sigurohet edhe prej kontributeve të siguruara prej donatorëve të tjerë, kredive etj. Këto organizata ndërkombëtare dhe shtete donatore, si: Banka Botërore (BB) “Nxitja dhe Levimi i Mundësive për Sigurinë e Ujit” (i njohur me akronimin FLOWS), SCO, MIRU-K, WBIF, SIDA, BE, grant nga KfW, do të të vazhdojnë me projekte mbështetëse dhe kontributi i tyre për zbatimin e strategjisë për periudhën e parë tri vjeçare do të jetë në vlerë prej 135,717.000.00 €.

Tabela 4 : Ndikimi buxhetor i zbatimit të Strategjisë për periudhën 2023-2025

Viti	Buxheti qendror	Buxheti komunal	Fondet IPA	Grante te tjera	Huatë	Totali
2023	14,197.56				1,000,000.00	1,014,197.56
2024	3,981,032.20			4,417,000.00	14,900,000.00	23,298,032.20
2025	12,382,032.20			131,250,000.00	13,350,000.00	156,982,032.20
2026				50,000.00		
2027						
Totali	16,377,261.96			135,717,000.00	29,250,000.00	181,294,261.96

Shtojca 1: LIGJET E SEKTORIT DHE AKTIT NËNLIGJORE

Ligjet	
Ligji nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës	Ky ligj rregullon çështjet që kanë të bëjnë me administrimin e resurseve ujore dhe po ashtu i definojnë rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve relevante (Ministrisë, Autoritetit të Rajonit të Pellgjeve Lumore, Këshillit Ndërmarrës për Ujërat dhe komunave) në lidhje me menaxhimin e resurseve ujore. Ky ligj përcakton se parimi i menaxhimit të pellgjeve lumore dhe parimi shfrytëzuesi dhe ndotësi paguan do të zbatohen në Kosovë duke pasur për qëllim adoptimin e standardeve dhe politikave të BE-së në menaxhimin e resurseve ujore.
Ligji nr.05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit	I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 06/l-088. Ky ligj rregullon shërbimet ujore që përfshijnë furnizimin me ujë, grumbullimin dhe transportin e kanalizimit si dhe trajtimin e ujërave të ndotura. Ligji themelon Autoritetin Rregullator për Shërbime të Ujit (ARRU) si organ të pavarur rregullator që i përgjigjet direkt Kuvendit dhe vendos kuadrin ligjor për rregullimin e shërbimeve të ujit, përfshirë licencimin, përcaktimin e tarifave, standardet e shërbimit, të drejtat e konsumatorëve, ndërprerjen e shërbimit, etj. Ligji specifikon qartazi se përgjegjësitë për investime në shërbime ujore bëhen përmes Kompanive Rajonale të Ujit ose Ministrisë përgjegjëse për ndërmarrjet publike.
Ligji nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike	I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009. Ky ligj përcakton kornizën ligjore për ushtrimin e të drejtave pronësore në ndërmarrjet publike (NP) dhe rregullon qeverisjen korporative në këto ndërmarrje. Ai bën ndarjen e: (i) NP qendrore (përfshirë KRU-të dhe kompanitë rajonale të ujitjes) aksionar i të cilave është Qeveria e Kosovës (QeK) përmes ME, dhe (ii) NP lokale aksionare të cilave janë komunat. Përfaqësimi i komunave në bordet e drejtorëve të KRU-ve rregullohet me Rregulloren Nr. 02/2013 mbi kriteret për krijimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe pjesëmarrja e komunave në bordet e ndërmarrjeve rajonale të ujit.
Ligji nr.06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës	Ky ligj përcakton kompetencat, detyrat dhe funksionet e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës duke përfshirë veprimtarinë në fushën e shkencave gjeologjike në territorin e Republikës së Kosovës. Në kuptim të ujërave rregullon përgjegjësitë për studime dhe hulumtime hidrogjeologjike, ujërave nëntokësore, ujërave minerale dhe gjeotermale.
Ligji nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit	Ky ligj rregullon sistemin integral të mbrojtjes së mjedisit, reduktimin e rrezikut për jetë dhe shëndetin njerëzor, në bazë të konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm. Ligji adreson menaxhimin e ujërave të zeza në mënyrë marginale. Ai përcakton kërkesën për marrjen e lejes mjedisore të cilën e lëshon MMPHI për të gjitha impiantet dhe objektet të cilat i nënshtrohen Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (Neni 31.2).
Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës	Ky ligj rregullon sistemin e mbrojtjes dhe ruajtjes së përgjithshme të natyrës dhe vlerave të sajë. Në kuptim të ujërave ka për qëllim mbrojtjen dhe ruajtjen e larmisë biologjike dhe peizazhore në vendbanimet ujore.

Ligji nr.06/L-035 për Veprimtaritë Hidrometeorologjike	Ky ligj përcakton mënyrën e kryerjes së veprimtarive hidrometeorologjike, sistemin e paralajmërimit të hershëm, ekspertizën, produktet dhe shërbimet që ofrohen nga këto veprimtari, për të mbështetur me informacione, institucionet qendrore lokale dhe publikun si dhe institucionet ndërkombëtare e rajonale.
Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale	Ky ligj përcakton se komunat kanë përgjegjësi për “ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza...”. Komunat këto kompetenca i kanë deleguar tek KRU-të përmes marrëveshjeve për shërbime, pos për drenazh që mbetet përgjegjësi ekskluzive e komunave.
Ligji nr. 02/L-078 për Shëndetësi Publike	I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-048. Ky ligj përcakton institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e shëndetit publik, dhe në këtë kuadër përgjegjësinë për monitorimin e cilësisë së ujit për pije e vendos tek Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKSHP) i cili bënë monitorimin e cilësisë së ujit të pijes përmes Udhëzimit Administrativ (UA) Nr. 10/2021 për Cilësinë e Ujit të Destinuar për Konsum Njerëzor.
